



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RAPORTET E MONITORIMIT

12 - MUJORI VITI 2018

---

**Programet Buxhetore:**

1. Planifikim Administrim, Menaxhim
2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë
3. Arti dhe Kultura

## RELACION

### MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË 12 MUJORIT TË VITIT

2018

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.109 datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”i ndryshuar, paragrafi V “Monitorimi” si dhe Udhëzimi nr.22 datë 17.11.2016 “Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore” Ministria e Kulturës, për 12-mujorin e vitit 2018, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Për vitin 2018 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë.

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2018 është rishikuar gjatë vitit me aktin normativ nr.1 datë 26.07.2018 si dhe me aktin normati nr.2 datë 19.12.2018 dhe ka pësuar ndryshime të cilat paraqiten sipas tabelës më poshtë:

në 000/lekë

Programet	Artikulli	Buxheti fillestar 2018	shtesa/pakesime sipas AN.1	shtesa/pakesime sipas AN.2	Buxheti I Rishikuar 2018
<b>Planifikim, Menaxhimi dhe Administrimi</b>	Shpenzime personeli	115,276	(7,000)	(1,000)	107,276
	Shpenzime Korrente	45,000	-	-	45,000
	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
	<b>Totali</b>	<b>160,276</b>	<b>(7,000)</b>	<b>(1,000)</b>	<b>152,276</b>
<b>Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë</b>	Shpenzime personeli	280,624	15,135	-	295,759
	Shpenzime Korrente	154,448	-	-	154,448
	Shpenzime Kapitale	200,000	(7,000)	-	193,000
	<b>Totali</b>	<b>635,072</b>	<b>8,135</b>	<b>0</b>	<b>643,207</b>
<b>Arti dhe Kultura</b>	Shpenzime personeli	541,600	3,500	(3,000)	542,100
	Shpenzime Korrente	222,949	-	-	222,949
	Shpenzime Kapitale	450,000	-	(210,000)	660,000
	<b>Totali</b>	<b>1,214,549</b>	<b>3,500</b>	<b>207,000</b>	<b>1,425,049</b>
<b>TAVANET MK</b>	Shpenzime personeli	937,500	11,635	(4,000)	945,135
	Shpenzime Korrente	422,397	-	-	422,397
	Shpenzime Kapitale	650,000	(7,000)	210,000	853,000
	<b>TOTALI</b>	<b>2,009,897</b>	<b>4,635</b>	<b>206,000</b>	<b>2,220,532</b>

Në mbështetje të Aktit Normativ nr.1, shpenzimet e personelit u shtuan rreth 18,635 mijë lekë nga totali i fondeve të kërkuara nga ana e MK prej 31,352 mijë lekë pasi tavanet per paga nuk i mbulonin nevojat e MK sipas strukturave në fuqi, (nga ku vlera prej 11,635 mijë lekë u plotësua

nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe pjesa tjetër prej 7,000 mijë lekë u plotësua nga fondet e lira që deklaroi Ministria e Kulturës në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018). Ndërsa shpenzimet kapitale u pakësuan në vlerën prej 7,000 mijë lekë në Programin e Trashëgimise dhe Muzeve.

Ndërsa përsa i përket Aktit Normativ nr.2 shpenzimet e personelit u pakësuan me 1,000 mijë lekë në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim, si dhe me 3,000 mijë lekë në programin e Artit dhe Kulturës nga deklarimi i fondeve të lira të MK si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018). Gjithashtu u avancua plani i investimeve me vlerë 210,000 mijë lekë për projektin me kod M120763 “Rikonstruksion TKOB” në programin Arti dhe Kultura me qëllim përmbushjen e prioriteteve të sistemit të kulturës.

Krahas rishikimeve të Buxhetit fillestar për vitin 2018, buxheti ka pësuar ndryshime gjatë vitit edhe si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM apo edhe nga rishpërndarjet e fondeve midis shpenzimeve korrente, cilat paraqiten në mënyrë tabelare si më poshtë:

në 000/lekë

Programet	Artikulli	Buxheti fillestar I rishikuar	shtesa/pakesime (nga VKM, transferime)	Plani Perfundimtar 2018
<b>Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim</b>	Shpenzime personeli	107,276	(17,000)	90,276
	Shpenzime korrente	45,000	23,402	68,402
	Shpenzime Kapitale	-	-	-
	<b>Totali</b>	<b>152,276</b>	<b>6,402</b>	<b>158,678</b>
<b>Trashëgimia dhe Muzete</b>	Shpenzime personeli	295,759	(5,418)	290,341
	Shpenzime korrente	154,448	20,887	175,335
	Shpenzime Kapitale	193,000	-	193,000
	<b>Totali</b>	<b>643,207</b>	<b>15,469</b>	<b>658,676</b>
<b>Arti dhe Kultura</b>	Shpenzime personeli	542,100	(21,578)	520,522
	Shpenzime korrente	222,949	61,327	284,276
	Shpenzime Kapitale	660,000	-	660,000
	<b>Totali</b>	<b>1,425,049</b>	<b>39,749</b>	<b>1,464,798</b>
<b>TAVANET MK</b>	Shpenzime personeli	945,135	(43,996)	901,139
	Shpenzime korrente	422,397	105,616	528,013
	Shpenzime Kapitale	853,000	-	853,000
	<b>Totali</b>	<b>2,220,532</b>	<b>61,620</b>	<b>2,282,152</b>

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme Buxheti ka pësuar këto ndryshime referuar programeve të MK:

#### 1. Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Përsa i përket transferimeve, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 17,000 mijë lekë gjatë vitit 2018, si rezultat i krijimit të fondeve të lira nga mosplotësimi i vendeve vakante nga DAP për vitin 2018 duke i transferuar në shpenzime korrente me qëllim shlyerjen e detyrimeve për vendimet gjyqësore të formes së prerë të krijuara gjatë viti 2018.

Gjithashtu shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 6,302 mijë lekë si rezultat i VKM nr.538 datë 19.09.2018 “Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Kulturës” me qëllim kryerjen e pagesave të kuotave të antarësimit në Observatorin Evropian të Medias, detyrime të prapambetura për vitet 2006-2013,

si dhe në vlerën prej 100 mijë lekë referuar kërkesave të paraqitura nga Aparati i MK në mbështetje të VKM nr.929 datë 17.11.2010, i ndryshuar “Për përdorimin e Fondit të Veçantë”.

## 2.Programi Trashëgimia dhe Muzetë

Për këtë program, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 5,418 mijë lekë gjatë vitit 2018, si rezultat i krijimit të fondeve të lira nga mosplotësimi i vendeve vakante të institucioneve të varësisë, të cilat u transferuan në shpenzimet korrente me qëllim përdorimin e tyre kryesisht për shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formes së prerë dhe për realizimin e aktiviteteve në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut.

Gjithashtu shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 14.000 mijë lekë nga VKM nr.186 datë 29.03.18 "Për një shtesë fondi .....si viti mbarëkombëtar I Gjergj Kastriot Skenderbeut" si dhe në vlerën prej 1,461 mijë lekë referuar kërkesave të paraqitura nga institucionet e Trashëgimisë në mbështetje të VKM nr. 929 datë 17.11.2010 i ndryshuar “Për përdorimin e Fondit të veçantë” i ndryshuar.

## 3.Programi Arti dhe Kultura

Referuar transferimeve, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 21,578 mijë lekë gjatë vitit 2018, si rezultat i krijimit të fondeve të lira nga mosplotësimi i vendeve vakante të institucioneve të varësisë, duke u transferuar në shpenzimet korrente me qëllim përdorimin e tyre për shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për realizimin e kalendarve artistik në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut.

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 38,000 mijë lekë si rezultat i VKM nr.186 datë 29.03.18 "Për një shtesë fondi .....si viti mbarëkombëtar I Gjergj Kastriot Skenderbeut" dhe në vlerën prej 1,749 mijë lekë referuar kërkesave të paraqitura nga institucionet e Artit në mbështetje të VKM nr.929 datë 17.11.2010 “Për përdorimin e Fondit të veçantë” i ndryshuar.

Përsa i takon ndryshimevë të planit , Ministria e Kulturës ka paraqitur reflektimet e duhura edhe në planin e produkteve në sasi dhe në vlerë mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020.

Gjatë vitit buxhetor krahas planit rëndësi të veçantë i është dhënë dhe zbatimit të buxhetit si nga Aparati I MK dhe nga institucionet e varësisë me qëllim realizimin e objektivave dhe produkteve të planifikuara.

Më poshtë prezantojmë realizimin e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2018 referuar Planit Përfundimtar të vitit 2018, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë:

## A-Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve

në 000/lekë

Nr.	Programet	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi ne (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
		Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	158,678	6.95%	157,307	6.97%	99.14%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	658,676	28.86%	650,356	28.81%	98.74%
3	Arti dhe Kultura	1,464,798	64.18%	1,449,824	64.22%	98.98%
	<b>Totali</b>	<b>2,282,152</b>	<b>100%</b>	<b>2,257,487</b>	<b>100%</b>	<b>98.92%</b>

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti në total është realizuar në masën 98.92 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Referuar planit vjetor rreth 64.18 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 98.98 % , ndjekur nga programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 28.86 % , të cilat janë realizuar në masën 98.74 % si dhe rreth 6,95 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i të cilit është realizuar në masën 99.14 % .

## B-Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

në 000/lekë

Gr.	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi ne (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
			Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	600-601	Shpenzime Personeli	901,139	39.49%	892,257	39.52%	99.01%
12	602-606	Shpenzime Korrente	528,013	23.14%	513,434	22.74%	97.24%
12	230-231	Shpenzime Kapitale	853,000	37.38%	851,796	37.73%	99.86%
	<b>Totali</b>		<b>2,282,152</b>	<b>100%</b>	<b>2,257,487</b>	<b>100%</b>	<b>98.92%</b>

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 98.92 % ndaj planit për 12-mujorin e 2018. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 39.49 % të totalit dhe janë realizuar në masën 90.01 % .

Shpenzimet korrente zënë rreth 23.14 % të totalit dhe janë realizuar në masën 97.24 % nga ku përkatësisht:

-Artikulli 602 është realizuar në masën 98.6 %, fond që është përdorur kryesisht për realizimin e shërbimeve të domosdoshme nga ana e institucioneve të MK , si shpenzime të ruajtjes dhe sigurisë për institucionet e artit dhe trashëgimisë, shpenzime të mirmbajtjes, shpenzime (udhetime dhe dieta) për përballimin e lëvizjeve të specialistve të fushës në objekte që janë në kujdestari të institucioneve të MK etj.

-Artikulli 604 është realizuar në masën 96 %. Mosrealizimi i këtij zëri në masën e 10,000 mijë lekë ka ardhur si rezultat i mos përdorimit të plotë të fondit të dhënë me VKM nr.186 datë 29.03.18 "Për një shtesë fondi .....si viti mbarëkombëtar i Gjergj Kastriot Skë nderbeut", i cili nuk mund të transferohej për projekte me destinacion tjetër.

-Artikulli 605, fond që është përdorur për pagesën e kuotizacioneve në bazë të marrëveshjeve që ka MK me organizata ndërkombëtare, si Creative Europe, Europa Citezen, Traduci etj.

Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 37.38 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99.86 % ndaj planit për 12 mujorin e 2018, kjo dhe si rezultat i ndjekjes me përgjegjesi nga ana e MK.

Përsa i takon investimeve për vitin 2018, Ministria e Kulturës është përqëndruar përkatësisht në këto projekte:

1-Projekti Teatri i ri Turbina, me dy skena, dhe platforma multi funksionale arti, (Inaguruar) Projekt që startoi në vitin 2016 dhe perfundoi ne vitin 2018, brënda afateve ligjor .

2-Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proçes

Projekt që ka startuar në vitin 2017 dhe vijon punimet edhe për vitin 2019. Nga vlera totale e këtij investimi është realizuar deri në fund të vitit rreth 49 % e vlerës së këtij projekti.

Me qëllim përmbushjen e prioriteteve të qeverisë, që finalizimi i rikonstruksionit të godinës së TKOB të përfundojë në vitin 2019 dhe të vijohet njëkohësisht me blerjen e pajisjeve të kësaj godine jemi mbeshtetur nga Keshilli Ministrave, ku me Aktin Normativ nr.2 dt 19.12.2018, MK iu shtua një fond prej 210,000 mijë lekë, me qëllim lirimimin e fondeve të planifikuara për vitin 2019 për blerjen e pajisjeve te TKOB.

3-Hartimi i Projektit për Rikonstruksionine Muzeut Historik Kombëtar.

Projekt i përfunduar me sukses në vitin 2018 por diferenca e mbetur prej 5,000 mijë lekë është planifikuar të likujdohet me buxhetin e vitit 2019.

4-Hartimi i Projektit për Galerinë e Arteve ka perfunduar brënda afateve të vitit 2018.

5-Investime në fushën e trashëgimisë kulturore si nderhyrjet në 9 objekte si kisha, muze dhe banesa, projekte të cilat kanë përfunduar dhe janë realizuar rreth 100%.

Gjithashtu vlen per tu permendur që situata emergjente e Biblotekës Kombëtare për shkak të depërtimit të ujit në sallën P300, në hapsirën depozituese të koleksioneve bibilotekare, në katet e nëndheshme të ndërtesës qëndrore të BKSH-së u perballua po nga fondet ne dizpozicion të Mk për vitin 2018 dhe nëpermjet mirëmenaxhimit të çdo qindarke që u rezultua fond I lirë nga proçedurat e prokurimit për shpenzimet kapitale.

Për vitin 2018, drejtuesit e Programeve kanë ndjekur me përgjegjshmëri procesin e realizimit të fondeve buxhetore duke siguruar menaxhimin e buxhetit nëpërmjet:

a) monitorimit të objektivave bazuar në treguesit e performancës.

b) si dhe monitorimit të produkteve që bëhet në sasi dhe vlerë.

Gjatë monitorimit vjetor Ministria e Kulturës ka evidentuar për çdo program realizimin e qëllimeve, objektivave dhe të treguesve të performancës të planifikuara nga ato të realizuara në fakt sikurse prezantohet në mënyrë të detajuar më poshtë:

Krahas **Buxhetit** të akorduar për vitin 2019, Ministria e Kulturës ka realizuar shpenzime dhe nga të ardhurat jashtë limitit për të tre programet e MK përkatësisht:

në 000/lekë

Programi	Art 600	Art 601	Art 602	Art 604	Art 605	Art 606	Totali
<b>01110</b>			400	8,040			<b>8,440</b>
<b>08220</b>	717	158	17,702	143		184	<b>18,904</b>
<b>08230</b>			643	13,894	17,892		<b>32,430</b>
<b>Total</b>	<b>717</b>	<b>158</b>	<b>18,745</b>	<b>22,078</b>	<b>17,892</b>	<b>184</b>	<b>59,773</b>

Referuar tabelës rreth 50 % e shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit janë kryer nga Programi Arti dhe Kultura në vlerën prej 32,430 mijë lekë nga institucionet:

-Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

-Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Këto shpenzime janë kryer për mbështetjen dhe realizimin e projekteve atistike me qëllim promovimin e artit dhe kulturës.

Ndërsa Programi i Trashëgimisë dhe Muzeve ka realizuar shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit në vlerën prej 18,904 mijë lekë nga institucionet si :

-Muzeu Historik Kombëtar.

-Instituti i Monumenteve të Kulturës.

-Zyra e Administrimit dhe Koordinimit Butrint

Këto shpenzime janë kryer për mbështetjen dhe realizimin e projekteve atistike me qëllim mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim ka realizuar shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit në vlerën prej 8,440 mijë lekë kryesisht për realizimin e Projektit Creative Europe, marrëveshje kuadër mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për Creative Europe, e nënshkruar në qershor të vitit 2014. Sipas kësaj marrëveshjeje granti përbëhet nga shuma e financimit të BE (50%) dhe 50% e mbetur që e vendos shteti palë.

Granti i akorduar nga BE përdoret për të financuar:

- botime dhe broshura ilustruese e promovuese per Creative Europe.
- Evente rajonale te ndryshme/blerje pajisjesh etj
- Honorare per ekspertet/asistente te programit

Që nga momenti i aderimit të Shqipërisë në këtë program, operatorët shqiptarë që kanë aplikuar dhe janë përzgjedhur për financim, kanë përfutur rreth 1 milion Euro. Mënyra e financimit në këtë program është 60% financohet nga Programi dhe 40% sigurohen nga vetë organizata. Fushat në të cilat është arritur më shumë sukses janë thirrjet: “përkthimet letrare”- libri si dhe kinematografia.

### 1. Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi ne (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
				Ne mije leke	Struktuarane %	Ne mije leke	Struktuarane %	
12	01110	600-601	Shpenzime Personeli	90,276	56.89%	89,780	57.07%	99.45%
12	01110	602-606	Shpenzime Korrente	68,402	43.11%	67,527	42.93%	98.72%
12	01110	230-231	Shpenzime Kapitale	-	0.00%	-	0.00%	
		<b>Totali</b>		<b>158,678</b>	<b>100%</b>	<b>157,307</b>	<b>100%</b>	<b>99.14%</b>

Nga të dhënat rezulton se buxheti është realizuar në masën 99.14 % ndaj planit të 12-mujorit 2018, nga ku shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 56.89 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99.45 % ndaj planit të 12 mujorit 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 43.11 % të totalit dhe janë realizuar në masën 98.72 % ndaj planit të 12 mujorit 2018.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në pesë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.



Kodi i Programit	0110	Emertimi i programit:	P lanifikim, Menaxhim, Adminis trim					
Qellimi 1	Rritja e cilesise se punes; Perafrimi legjis lacionit shqiptar me ate te BE-se per permbushjen e e kriterëve ne fushen e kultures qe rrjedhin nga MSA dhe asquis communautaire; Pershtatja e strukturave aktuale ne baze te objektivave te MK; Zbatim i legjis lacionit te fushes; Kontroll dhe auditim te struktures se Ministrise e Kultures; Finalizimi i marrevjes hjeve dypalsh e dhe proto kolleve te bashkepunimit dhe pjesmarria e Shqiperise ne takime rajonale dhe nderkombetare							
			*Treguesit e performancës/P produktet:					
*Objektivat e politikës *	Kodi i Treguesit te Performan	Emertimi i Treguesit te Performances **/P produktit	Niveli faktik i vitit paraardhe	Niveli i planifikuar ne vitin koorent	Niveli i ris hikuar ne vitin koorent	Niveli i planifikuar per periudhen	Niveli faktik ne fund te vitit	% e Realizimit te Treguesit te Performance
Objektivi L1	Pemisimi i legjis lacionit ekzistues e, hartimi i akteve te reja ligjore dhe nenligjore ne perputhje me programin e qeverise dhe detyrimeve qe rrjedhin nga MSA sipas fushes se veprimtarise se MK							
	G	Miratimi i legjis lacionit dhe akteve ligjore ne zbatim te tij	47,518	57,652	57,652	69,182	69,182	100%
Objektivi L2	Ngritja e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese per stafin e MK per permbushjen me cilesite raportimeve							
	H	Trajnime per stafin me qellim permbushjen me cilesite raportimeve	32,900	46,763	46,763	34,293	34,293	100%
Objektivi L3	Pemisimi i kushteve te Punes per punonjesis te MK per permbushjen me cilesite pune							
	M	Rinovim te pajisjeve egzistues e	1,492	-	-			#DIV/0!
Objektivi L4	Respektimi i proceduarave ligjore ne raport me te tretet dhe shlyerja ne kohe e detyrimeve gjyqesore							
	I	Zgjidhje e konflikteve me te tretet dhe shmangie e detyrimeve te prapambetura	26,923	6,100	6,100	14,550	13,179	91%
Objektivi L5	Miremenaxhim dhe perdorim me efektivitet te fondeve buxhetore dhe reduktim te parregullsive te konstatuara nepermjet auditimeve te brendshme							
	J	Zbatim te legjis lacionit ne fuqi per Aparatin dhe Institucionet e varesise	32,800	36,997	29,997	27,889	27,889	100%
Objektivi L6	Intensifikimi i bashkepunimit rajonal dhe nderkombetar dhe promovimi i kultures dhe trashegimis e kulturore nepermjet fondeve dhe programeve te Bashkimit Evropian							
	K	Marreveshje bilaterale te nenshkruara dhe aplikime per thithe fonde shene	13,368	12,764	12,764	12,764	12,764	100%

Nga sa më sipër rezulton se produktet e listuara në këtë program janë realizuar sipas pritshmërive dhe në disa raste janë tejkaluar dhe parashikimet.

Për sa i përket **Produktit G** “Miratimi i legjis lacionit dhe akteve ligjore në zbatim të tij” është realizuar pothuajse plotësisht sipas planit të ndryshuar për 12-mujorin e 2018. Gjatë vitit 2018 një nga objektivat kryesor për MK ka qënë:

-Realizimi i Planit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2018, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.37, datë 24.1.2018 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik, të projektakteve”.

Në total ishin parashikuar për tu miratuar në Këshillin e Ministrave 20 akte.

Nga këto akte, 4 janë miratuar në Këshillin e Ministrave ndërsa 16 akte në fazë hartimi dhe/ose bashkërendimi me strukturat përkatëse të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të linjës, sipas parashikimit të bërë në tabelat si vijon:

## 1. TABELA E AKTEVE TË PROGRAMIT ANALITIK PËR VITIN 2018 TË MIRATUARA/PROCES

Nr .	Akti	Lloji i aktit	Miratuar/ Në proces	Arsyet e mosrealizimit
1.	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” i ndryshuar,	Projektligj	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit me institucionet e linjës. Pas bashkërendimit fillestar të tij u propozuan ndryshime nga Këshili i Ministrave dhe u ridërgua për mendim final në institucionet e linjës.
2.	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar BSH/DATANLA të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 134 datë 7.3.2018	-
3.	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin ËEBGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 133 datë 7.3.2018	-
4.	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 278 datë 16.5.2018	-
5.	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 16.1.2019	-
6.	Për shumat e shpërblimit nga riprodhimi i veprave për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal	Projektvendim	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së konsultimit me grupet e interesit.
7.	Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Tragjas i Vjetër dhe miratimin e rregullores së administrimit të tij.	Projektvendim	Në proces	Mungon zoonimi nga drejtorite teknike
8.	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2017-2022	Projektvendim	Në proces ka kaluar ne PPA 2019)	Për shkak të ndjekjes së procedurës së konsultimit me strukturat përkatëse në Ministrinë e Kulturës dhe grupeve te interesit
9.	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616 datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”	Projektligj	Në proces (RIA) ka kaluar ne PPA 2019)	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
10.	Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimit të anëtarëve të	Projektvendim	Në proces ka kaluar ne PPA	Ne proces hartimi

	organeve kolegjiale në fushën e trashëgimisë kulturore.		2019)	
11.	Për procedurat e konkurrit publik në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike në trashëgiminë kulturore	Projektvendi	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së hartimit
12.	Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike.	Projektvendi	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së konsultimit me strukturat përkatëse në Ministrinë e Kulturës.
13.	Për strukturën, mënyrën e organizimit dhe funksionimit në zyrën dhe degët territoriale të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore	Projektvendi	Prashikuar në 2020	
14.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	Projektvendi	Në proces (ka kaluar në PPA 2019)	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
15.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	Projektvendi	Në proces (ka kaluar në PPA 2019)	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
16.	Për projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre	Projektvendi	Në proces ka kaluar në PPA 2019)	
17.	Për mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore	Projektvendi	Në proces ka kaluar në PPA 2019)	
18.	Për kushtet dhe kriteret e licencimit në fushën e Trashëgimisë Kulturore	Projektvendi	Në proces ka kaluar në PPA 2019)	Për këtë projektakt është doktrësuar që për secilin prej llojeve të licencave të jetë një projektakt i veçantë sipas parashimeve të ligjit nr. 27/2018.
19.	Për kushtet dhe kriteret e licencimit në kryerjen e veprimtarisë arkeologjike	Projektvendi	Në proces ka kaluar në PPA 2019)	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
20.	Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim indirekt personave fizike apo juridikë, publikë ose privatë.	Projektvendi	Në proces ka kaluar në PPA 2019)	Faze hartimi

## 2. TABELA E AKTEVE JASHTË PROGRAMIT ANALITIK PËR VITIN 2018 TË REALIZUARA

Nr.	Akti	Lloji i aktit	Miratuar
1.	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 11 veprave të piktorit të popullit Vangjush Mio, me qëllim ekspozimin e tyre në centro culturale Don Orione Artigianelli, Sala Tziano, dorsoduro 909/a – Venecia, Itali	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 121 datë 28.2.2018
2.	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurive nr. 8/638 dhe nr. 8/637, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 25, datë 9.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të pronave të paluajtshme të Bashkisë Tiranë”	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 186 datë 29.3.2018
3.	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve, pjesë të kalendarit për vitin 2018, si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 133 datë 7.3.2018
4.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Teatrit Kombëtar.	Projektvendim	Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 29 datë 17.1.2018
5.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve	Projektvendim	Miratuar me vendimin e

			Këshillit të Ministrave nr. 204 datë 11.4.2018
6.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326 datë 31.5.2018
7.	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, për sipërfaqen prej 235 m <sup>2</sup> , të pasurisë me numër 1/256, me sipërfaqe totale 1644 m <sup>2</sup> , me vendndodhje në zonën kadastrale 8150	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 372 datë 20.6.2018
8.	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për themelimin e Qendrës Kulturore të Kinës në Shqipëri	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 417 datë 4.7.2018
9.	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të veprës së artit në pikturë “Mbjellja e pemëve”, të autorit Edi Hila, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, e cila do të jetë pjesë e ekspozitës “Edi Hila Monography”, që organizohet në Muzeun e Artit Modern në Varshavë, Poloni	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 53 datë 31.1.2018
10.	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 795, datë 26.11.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve”	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 306 datë 23.5.2018
11.	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 203 datë 16.3.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Kulturës, të pronës nr. 186, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 3042, qendër stërvitore”, me vendndodhje në Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515 datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar”	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 29.9.2018
12.	Për kthimin në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar të letrave shqipe dhe të kulturës mbarëkombëtare Mid’hat Frashëri”	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 485 datë 31.7.2018
13.	Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për themelimin e Qendrës Kulturore të kinës në Shqipëri	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 417 datë 4.7.2018
14.	Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit godinës së re të Teatrit Kombëtar”	Projektligj	Miraturuar, ligji nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës, me objekt “projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të teatrit kombëtar”
15.	Projektvendim “Për miratimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.”	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 26.12.2018
16.	Projektvendim. “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”.	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 26.12.2018
17.	Projektvendim . “Për shfuqizimin e vendimit nr. 646, datë 29.12.1999 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të veprimtarisë së Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit”	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.787, datë 26.12.2018
18.	Projektvendim “për dhurimin UNESCO-s të ikonës “Ngjallja e Llazarit”, në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë”	Projektvendim	Miraturuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 29.9.2018

### 3. TABELA E AKTEVE JASHTË PROGRAMIT ANALITIK PËR VITIN 2018 NË PROCES

Nr.	Akti	Lloji i aktit	Miratuar/ Në proces	Arsyet e mosrealizimit
1.	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.602, datë 21.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare Kinematografike”, i ndryshuar”	Projektvendim	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
2.	Projektvendim “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, për rimbursimin e pjesshëm të fondeve të huaja të investuara në projektet kinematografike dhe audiovizuale që kryejnë xhirimet në territorin e Republikës së Shqipërisë”	Projektvendim	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
3.	Projektvendim. “Për përcaktimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të tyre në Republikën e Shqipërisë”.	Projektvendim	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
4.	Projektvendim. “Për përcaktimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dh zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë”.	Projektvendim	Në proces	Për shkak të ndjekjes së procedurës së bashkërendimit finale me institucionet e linjës.
6.	Projektvendim. "Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar. Dërguar për bashkërendim institucioneve të linjës.	Projektvendim	Në proces	Dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave
7.	Projektvendim “Për emërimin në detyrë të drejtorit të Teatrit Eksperimental “Kujtim Spahivogli”	Projektvendim	Në proces	Dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave

Kurse **Produkti H** “Administratë Funktionale” është realizuar në masën 100 % referuar planit të ndryshuar për 12-mujorin e 2018. Një tjetër objektivi me rëndësi gjatë këtij viti ka qënë dhe ngritja e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese për stafin e MK me qëllim përmbushjen me cilësi të detyrave funksionale. Në këtë aspekt stafi i MK-së, përgjatë vitit 2018 ka realizuar në total një numër prej 22 trajnimesh, tematikat e të cilave kanë qënë si më poshtë:

- Parimet e barazisë gjinore dhe buxhetimi i përgjigjshëm gjinor
- Konflikti i Interesit
- Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë
- Trajnimi I vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik

- Prezantimi i Udhëzimit të Ri Standard të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm
- Menaxhimi I Fondeve të asistencës financiare të BE-së
- Trajnim mbi përdorimin dhe funksionimin e sistemit HRMIS
- Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtare me acquis e BE-se. Përgatitja për pre-screening dhe metodologjia e shqyrtimit kundrejt neneve 34-36 TFBE
- Procesi i Integritetit të Shqipërisë në BE
- Prezantimi me Administratën (trajnim i detyrueshem në baze të ligjit për nepunesin civil në periudhë prove)
- Programi buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe buxheti i përgjigjshëm gjinor
- Harmonizimi i konsultimeve publike nepermjet qeverisjes
- Përgatitja dhe Prokurimi i Projekteve PPP në Ballkanin Perëndimor
- On the Framework of the Slovenia's Development Cooperation Program supporting Albanian LGUs on Preparation of the EU and Other International Projects.
- Statistika Zyrtare
- Për emergjencat civile
- Trajnim mbi zbatimin e procesit të vlerësimit të ndikimit (RIA)
- Fuqizimi i Menaxhimit të Financave Publike
- Trajnim i punonjësve mbi burimet Gjenetike, shprehjet tradicionale dhe folklori
- Trajnim për Sistemin e Menaxhimit elektronik të Dokumentave EDRMS
- Trajnim mbi monitorimin e fondeve buxhetore

Vlen për tu theksuar se në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, në MK kryen me sukses praktikën e punës 10 praktikantë për një periudhë 3 muajore (3 janar-3 prill) dhe në muajin qershor në kuadër të këtij programi u punësuan me kontratë 1 vjeçare të gjithë praktikantët.

Për **Produktin I** "Zgjidhje e konflikteve me të tretët dhe shmangie e detyrimeve të prapambetura", gjatë 12-mujorit të vitit 2018 janë krijuar detyrime kryesisht si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për të cilat Ministria e Kulturës ka shqyrtuar çdo fond që mund të rezultonte i papërdorur përpara mbylljes së vitit buxhetor me qëllim shlyerjen tyre duke respektuar rradhën e paraqitjes së tyre në zbatim të Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2018 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*".

Sikurse edhe nga praktika e vitit 2017, Ministria e Kulturës ka treguar edhe për vitin 2018 se ka mirëadministruar fondet e akorduara në ligjin vjetor të buxhetit 2018, në drejtim të realizimit të këtij objekti me qëllim shmangien e detyrimeve të prapambetura, duke likuiduar rreth 80%

nga vlera totale e tyre. Ndërsa pjesa tjetër e detyrimeve që mbetën pa likuiduar vjen si rezultat i pezullimeve të këtyre vendimeve nga Gjykata e Lartë.

Në lidhje me **Produktin J** “Zbatim të legjislacionit në fuqi për aparatën e MK dhe institucionet e varësisë”, në planin vjetor të ndryshuar, Sektori i Auditit të Brëndshëm, kishte planifikuar 11 misione auditimi me bazë sistemi të cilat janë realizuar në masën 100% bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet në fuqi si dhe në praktikat më të mira të fushës, me qëllim garantimin e një efieçence sa më të lartë.

Sipas auditimeve me bazë sistemi për vitin 2018, janë dhënë gjithsej 50 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, të cilat janë pranuar nga titullarët e institucioneve dhe i janë përcaktuar dhe afatet e realizimit të tyre.

Vlen për tu theksuar se për vitin 2018 nuk janë evidentuar gjetje me dëm ekonomik si dhe nuk ka patur çështje të dërguara për investigim financiar.

Ndërsa për **Produktin K** “Marrëveshje bilaterale të nënshkuara dhe aplikime për thithje fondesh në programet komunitare”, Ministria Kulturës në vitin 2018 ka nënshkruar pesë marrëveshje konkretisht:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me Rajonin e Pulias për konkretizimin e projektit “Shokë dhe engjej-Drejt Oficinave të Kulturës”, në kuadër të financimit të Parkut të Artit nënshkruar me datë 06.03.2018.

2. Protokoll i bashkëpunimit bazuar në “Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritetin strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”, e datës 11 janar 2014, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, nënshkruar me datë 18.06.2018.

3. Program bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Malit të Zi për periudhën 2018-2020, nënshkruar me datë 03.07.2018.

4. Marrëveshje për ngritjen e qendrës kulturore Kineze në Shqipëri, nënshkruar me datë 05.11.2018.

5. Marrëveshje me Palazzo Spinnelli në Firenze, nënshkruar në shtator 2018.

Ndërsa përsa i përket aplikimeve për thithje fondesh në programet komunitare, Ministria e Kulturës ka realizuar një aplikim madhor për të cilin po punohet për të shkruar Application package, atë të IPA me Tematikë Shqipëri - Mali i Zi - Itali: “Parku I Artit” si dhe katër projekte në kuadër të programit ADRION, në cilësinë e partnerit.

ADRION është një program transnacional që ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin në fushën e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore në tetë shtetet pjesëmarrëse: Shqipëri, Bosnje HERCEGOVINË, Mali I Zi, Kroaci, Greqi, Itali, Serbi dhe Slloveni.

Aplikimet synojnë krijimin e rrjeteve të përbashkëta me struktura të caktuara në këto shtete për fuqizimin e teatrove, Trashëgimisë Kulturore, restaurimit të monumenteve dhe bashkëpunimin në fushën e dixhitalizimit të muzeve.

## **2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”**

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	08220	600-601	Shpenzime Personeli	290,341	44.08%	285,760	43.94%	98.42%
12	08220	602-606	Shpenzime Korrente	175,335	26.62%	171,984	26.44%	98.09%
12	08220	230-231	Shpenzime Kapitale	193,000	29.30%	192,612	29.62%	99.80%
		<b>Totali</b>		<b>658,676</b>	<b>100%</b>	<b>650,356</b>	<b>100%</b>	<b>98.74%</b>

Sipas tabelës vëmë re se buxheti është realizuar në masën 98.74 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 44.08 % të totalit dhe janë realizuar në 98.42 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 26.62 % të totalit dhe janë realizuar në masën 98.09 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 29.30 % të totalit dhe janë realizuar në masën prej 99.80 % ndaj planit të 12-mujorit 2018.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në katër produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme



Kodi i Programit	08220	Emertimi i programit:	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete							Komente
Qellimi 1	Rruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë materiale (monumente të kulturës, ansamble arkitektonike, qytete muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike) - rritjen e aksesit të publikut në të një funksion të turizmit kulturor								.....	
	<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>								.....	
	<b>*Objektivat e politikës*:</b>	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli i planifikuar per periudhen progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit									.....
		F	Objekte te restauruara dhe te mirembajtura	276,711	409,152	372,938	405,882	400,117	99%	
Objektivi 1.2	Përmirësimi i standarteve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në muzete dhe objektet e vizitueshëm të Trashëgimisë Kulturore / parqeve arkeologjik									
		G	Muze paqë te mirembajtura	160,944	158,861	231,912	197,811	190,254	96%	
Objektivi 1.3	Inventarizimi i 5000 objekteve dhe/ose elementeve te trashëgimisë jomateriale dhe pajisja me karte teknike									
		I	Objekte te inventarizuara	9,665	10,425	9,912	10,918	10,564	97%	
Qellimi 2	Rruajtja e trashëgimisë jomateriale, rivitalizimin e gjuhës dhe zhvillimin e diversitetit kulturor								.....	
	<b>**Treguesit e performancës/Produktet:</b>								.....	
	<b>*Objektivat e politikës*:</b>	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli i planifikuar per periudhen progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 2.1	Promovimi i shteteve të trashëgimisë shpirtërore, materiale dhe diversitetit kulturor përmes zhvillimit të 70 veprimtarive të përvitshme.									.....
		H	Aktivite, veprimtari kulturore	46,964	56,634	28,445	44,573	43,058	97%	.....

## ➤ Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit

### 1. Objekte te restauruara dhe të mirëmbajtura

Në vitin 2018, për Programin “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë”, fondet për investime nga buxheti i shtetit ishin në masën është **193,000** mijë lekë.

U mundësua restaurimin i 10 objekteve monument kulture si dhe hartimi i projektit për Restaurimin dhe Reformulimin e linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar –Tiranë, projekti i Restaurimit dhe rehabilitimit i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve, si dhe blerje pajisjesh kompjuterike për të plotësuar me të gjithë aksesoret e nevojshëm biletaritë në disa muze apo monumente kulture të vizitueshëm me biletë.

Përfundoi likuidimi i projektit për ngritjen e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethë” si dhe pagesa e TVSH - Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeor dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë Fier financuar nga BE në kuadër të programit IPA multibeneficiary.

U krye **Restaurimi i Banesës së Vëllezërve Frashëri** dhe **Restaurimi i Muzeut të Sinjës – Dibër**. Restaurimi i këtyre dy objekteve bëri të mundur shmangien e degradimit të mëtejshëm të

tyre, kthimin e vlerave për trashëgiminë tonë kulturore si dhe futjen e këtyre objekteve në itineraret turistike të zonës por dhe më gjerë.

Ka përfunduar **projekti për “Restaurimin dhe Riformulimi i linjës muzeore të Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë”**, si dhe projekti për **Restaurimin dhe Rehabilitimin e hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve**.

Gjithashtu u restauruan e 8 objekte, në 6 kisha dhe 2 ura, monumente kulture të kategorisë së I-rë. Restaurimi i këtyre objekteve krijon mundësinë e ruajtjes së tyre nga degradimi i mëtejshëm, ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, kthimin e këtyre objekteve komunitetit si dhe shtimin e itinerareve turistike me këto objekte me vlera të trashëgimisë sonë.

Kështu u kryen:

- **Restaurim Kisha e Shën Mërisë në Ristoz, Korçë, Faza e III-të**, restaurimi i kishës, i cili ka filluar në vitin 2014 - 2015. Restaurimi bëri të mundur heqjen e një monumenti mjaft të rëndësishëm të trashëgimisë sonë nga lista e riskut të lartë.

- **Restaurim Kisha e Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme - Gjirokastrë**, u kryen ndërhyrje restauruese në mure, kupolë, çati, restaurim dhe konservim i pikturave, si dhe restaurim i të gjithë elementeve arkitektonikë në brendësi të Kishës.

- **Restaurim Kisha e “Shën Apostujve” Hoshtevë, Zagori**, u kryen ndërhyrje restauruese të muraturës së narteksit, kambanorja, si dhe ndërhyrje në çati, në fugatime të muraturës, në pikturën murale, dekoracionet prej druri, si dhe sistemime të sheshit përreth (drenazhim dhe plotësim i murit të rrethimit). Krahina e Zagorisë, ku ndodhet fshati i Hoshtevës, shquhet për bukuritë e rralla natyrore dhe trashëgiminë kulturore të saj. Vlerësimi dhe mirëmbajtja e kësaj trashëgimie, ndihmon në rritjen e vlerave dhe njohjen më tej të kulturës së kësaj zone. Në këtë këndvështrim, restaurimi i Kishës së Hoshtevës, do të ndihmojë në njohjen e kulturës dhe traditës së ndërtimitarisë së zonës dhe të periudhës të cilës ajo i përket. Bazilika e shekullit të 19-të e “Apostujve Pjetri dhe Pali”, vlerësohet për nga trajtimi arkitektonik i saj dhe për kambanoren e veçantë oktagonale. Restaurimi i saj, do ta risjellë në vëmendje këtë monument si për vizitorët e krahinës ashtu edhe për studiuesit.

- **Restaurim i kishës së Shën Nikollit (Vend varrimi Skënderbeut) – Lezhë**, punimet e restaurimit ishin thelbësore dhe të domosdoshme për ti dhënë objektit rëndësinë dhe paraqitjen dinjitoze, këtij monumenti me interes të veçantë historik, arkeologjik e kulturor.

- **Restaurim "Kisha e Shën Thanasit"- Leshnicë-Sarandë**. Ndërhyrjet konsistuan në konservimin dhe konsolidimin e pjesës së mbetur të Kishës pas tërmetit në vitin 2017. U kryen pajantimi i gjithë qemerëve dhe kupolave, konservimi e konsolidimi i pikturës murale, ringritja e murit jugor të naosit, ringritja e tre kolonave të naosit me materialin origjinal të ndodhur në vend, çmontimi i çatisë së nartekstit e ndërtimi i një çatie të re, çmontimi i paretit të brendshëm në disa zona në nartekst dhe rindërtimi i tyre, përforcimi i strukturës nëpër qoshe, vendosja e një tavani dërrase, restaurimi i dyerve të drurit etj.

- **Restaurim Kisha Manastirit të Shën Mërisë Mesopotam Faza I -Sarandë**, në përmjet këtij projekti u mundësua ruajtja dhe konsolidimi i skemës ekzistuese statike, funksionale dhe tipologjike të këtij objekti me vlera për trashëgiminë tonë kulturore dhe arkitektonike. Punimet filluan me ndërtimin e një mbulese të përkohshme, për mbrojtjen nga lagështia për gjithë strukturën e kishës, puntelimin e qemerëve dhe harqeve të kupolave për të siguruar qëndrueshmërinë e objektit gjatë punimeve. U kryen fugatime, injektime, riplotësime të elementëve konstruktivë të shoqëruara me qepje të çarjeve, integrimin e pjesëve të reja të muraturës me të vjetrat si dhe restaurimin e çatisë. Struktura përforcohet me tiranta inoksi,

plotësim kolonash nën harkadë duke e rikthyer në gjendjen e mëparshme si dhe injektimi i muraturës, dhe fugatimi i saj.

- **Restaurimi i Objektivit Ura e Kollorcës 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat,** me anë të kësaj ndërhyrje, u siguroa qëndrueshmëria e urës dhe mundësia e restaurimit të plotë të saj në të ardhmen. Është realizuar vetëm faza e shpëtimit, faza emergjente. Ndërhyrjet konsistuan në përforcimin e dy prej këmbëve të urës.

- **Restaurim Ura Nivanit, Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastrë,** u krye pastrimi nga bimësia e lartë dhe e ulët e cila kishte mbuluar urën, fugatimi i plotë i trupit të urës dhe sidomos i qemerëve të cilët ishin të rrezikuar nga mungesa e materialit lidhës, restaurimi i kalldrëmit të urës duke ruajtur teknikën origjinale, përforcimi me beton i njërit prej këmbëve, në themelin e saj duke penguar humbjen e materialit nga rrjedha e ujit.

Detajimi i fondeve është sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi i projektit	mijë Lekë	
	Plani	Realizimi
Muzealizimi Muzeut Gjethi	4,501	4,501
TVSH - Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë	5,845	5,845
Blerje Pajisje, Aparati MK	1,254	1,254
Projekti i Restaurimit dhe Rifolmulimi i linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar-Tiranë	35,000	35,000
Projekti i Restaurimit dhe rehabilitimit i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve	14,800	8,928
Restaurim "Banesa Vëllezërve Frashëri"	5,994	5,991
Restaurim "Muzeu i Sinjës" - Dibër	1,484	1,484
Restaurimi i Kishës së Ristozit Mborje Korçë, faza III	3,896	3,891
Restaurimi Kisha Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme-Gjirokastrë	24,127	24,114
Restaurimi me objekt Kisha e Shën Apostujve, Hoshteve -Zagori	19,199	19,195
Restaurimi i Kishës së Shën Nikollit (vend varrimi i Skënderbeut) - Lezhë	33,241	33,241
Restaurim me objekt Kisha e Shën Thanasit-Leshnicë-Sarandë	10,113	10,046
Restaurim Kisha Manastirit të Shën Merise Mesopotam Faza I - Sarandë	24,127	24,114
Restaurim me objekt Ura e Kollorcës, 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat	4,980	4,980
Restaurim Ura Nivanit, Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastrë	2,356	2,356
Blerje pajisje, Muzeu Kombëtar i artit Mesjetar Korçë,	239	156
Blerje pajisje, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlore	111	110
Blerje pajisje, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Gjethi"	111	107
Blerje pajisje, DRKK Durrës	222	149
Blerje pajisje, Qendra Muzeumeve Berat	17	17
Blerje pajisje, DRKK Gjirokastrë	17	17
Blerje pajisje, Parku Kombëtar Apoloni	17	17
Blerje pajisje, DRKK Vlore	111	111
Regjistrimi i pasurive kulturore kombëtare në qendrën e regjistrimit fizik on-line	1,164	1,164
<b>TOTALI</b>	<b>193,000</b>	<b>186,660</b>

## 2.MIREMBAJTJA E MONUMENTEVE TË KULTURËS

Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës, në përmbushje të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës “Të ruajë, mbrojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore”, i kushton vëmendje të veçantë rehabilitimit të monumenteve të kulturës për t’i shndërruar ato dhe në produkte turistike kulturore, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, Parqeve Kombëtarë Arkeologjike si dhe me mbështetjen e IMK dhe ASHA.

Në vazhdim të eksperiencës në menaxhimin e fondeve për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, nga fondet Art. 602 që institucionet kanë në dispozicion janë marrë masat për përdorimin me efektivitet të këtyre fondeve me synim mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës nëpërmjet konservimit, konsolidimit e restaurimit të tyre.

Theksojmë se këto fonde kanë qenë të pa mjaftueshme për të kryer mirëmbajtjen e monumenteve dhe në të shumtën e rasteve përdoren vetëm për të nxjerrë objektet nga zona e riskut.

Gjatë vitit 2018, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, me fondin e mirëmbajtjes, Art 602 dhe 602/5 - 13,549,055 lekë, anë kryer punime mirëmbajtjeje, konsolidimi, në rreth 120 objekte monument kulture dhe pastrim vegjetacioni në 92 objekte.

Këto institucione kryejnë mirëmbajtjen rutinë, mbrojtjen nga dëmtimet dhe degradimi nga agjentët atmosferikë, si dhe përgatisin objektet e trashëgimisë kulturore për sezonin turistik. Gjithashtu dhe Parqet Arkeologjike kryejnë punime mirëmbajtje të përqendruara në përmirësimin e performancës së institucioneve të trashëgimisë si edhe në ndërhyrje restauruese dhe mirëmbajtje në monumentet e kulturës.

Sipas Institucioneve janë kryer punime mirëmbajtje nga:

**DRKK Gjirokastrë**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer mirëmbajtje në 40 objekte si sistemime në Kalanë Gjirokastrë dhe ndërhyrje mirëmbajtje restauruese në rreth 22 banesa monument kulture në qendrën historike, kryesisht punime emergjente për çatitë dhe fasadat e objekteve. Punime mirëmbajtje, restauruese, konservuese në disa kisha, në objekte të tjera si ndërhyrje emergjente kroi i Selckës, ndërhyrje restauruese në portat hyrëse të kalave Gjirokastrë e Libohovë, mirëmbajtje, pastrime e sistemime në Parkun Antigone dhe Adrianopol. Inspektim dhe pastrim nga vegjetacioni në rreth 14 objekte si: kisha e Shën Mëhillit dhe kisha e Shën Thanasit në fshatin Lekël, Teqeja e Koshtanit, kalaja e Qytezës në fshatin Dukaj, në kalanë e Tepelenës, kalaja e Kalivaçit, kalaja e Zharres, kalaja e Nivicës, Mulliri i Nivicës, Akuadukti i Bënçës, urën metalike të Dragotit, ura Antiko – Mesjetare mbi lumin Vjosë, pastrim në rrënojat e urës së Muço Hysës, etj.

**DRKK Durrës**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer punime rutinë mirëmbajtje dhe pastrime nga vegjetacioni dhe mbeturinat, në rreth 41 objekte monument kulture. Janë kryer pastrime dhe mirëmbajtje në Bazilika Arapaj, në Muzeun Arkeologjik Durrës, Termat Romake, Macellum Forum (Rotonda), në Amfiteatër, në Hamamin Mesjetar Durrës, në Banesën Aleksandër Moisiu, Kalaja e Skënderbeut dhe Kisha e Shën Ndout në Kepin e Rodonit, në Rrënojat me mozaik GORA, etj. Pastrime dhe mirëmbajtje në kalanë e Prezës, në Murin e Portës, Pusin e Top Hanës, në Mozaikun e Tiranës, në Urën e Tabakëve etj. Punime mirëmbajtje kalaja e Elbasanit, kalanë e Ishmit, çezma dhe kalldrëmi në Rrapin e Bezistanit, kalaja Krujë,etj.

**DRKK Berat**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit dhe në disa objekte edhe në bashkëpunim me pronarët ka kryer ndërhyrje restauruese, mirëmbajtëse, konsolidime, pastrime nga vegetacioni i ulët dhe i lartë, në 41 objekte monument kulture kështu: pastrim nga vegetacioni në disa kisha në lagjen Kala, restaurim i disa ikonave, trajtimi i portave të kishave monument kulture në lagjen Kala, pastrim nga bimësia në Qendrën Historike të qytetit të Beratit, si dhe pastrim territori dhe mirëmbajtje të disa kishave në kalanë e Beratit. Gjithashtu janë kryer ndërhyrje emergjente në mure mbajtëse në lagjen Mangalem, Restaurimi i kalldrëmit në lagjen Goricë, pastrim nga vegetacioni në Mangalem, Goricë dhe Kala. Restaurim dhe mirëmbajtje në çatitë dhe fasadat e 14 banesave monument kulture, etj.

**DRKK Vlorë**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer mirëmbajtje në 16 objekte, si në punime mirëmbajtje kisha e Panaisë, kisha e Ipapandisë, Vendosija e biletarisë në kalanë e Kaninës, punime mirëmbajtëse Muzeu Etnografik, Muzeu Historik, Muri rrethues i kalasë së Onhezmit, Ura e Çinës mes Tatzatit e Kalasës, Vendosija e derës dhe pastrimi i kanaleve të drenimit në P A Amantia.

Inspektim dhe pastrim vegetacioni në rreth 40 objekte, si në: Manastiri i 40 shenjtorëve, Bazilika – Sinagogë Sarandë, Tempulli antik Çukë, Tempulli Antik Metoq, kisha e Shën Kollit Armen, Manastiri ishin Gjergjit, Leshnicë e Sipërme, Manastiri i Shën Thanasit, Leshnicë e Sipërme, Kullat e Manastirit të Theollogos, Manastiri i Shën Triadhës, Manastiri i Shën Thanasit Pecë, Manastiri Shën Kollit Mesopotam, Bazilika e Peshkopisë, Manastiri i Zvernecit, Kisha e Sergjit dhe Bakut, Kisha e Shën Stefanit Manastiri i Shën Mërisë Kakome Kalaja e Mavrovës Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Lëkursit, Kalaja e Himarës, etj.

**DRKK Shkodër**, ka kryer punime mirëmbajtje, pastrime dhe konsolidime në 12 objekte monument kulture. Punime restauruese dhe konsoliduese në Kalanë e Shkodrës, mirëmbajtje, pastrim vegetacioni Kalaja e Lezhës, Ura e Mesit, Kalaja e Grazhdanit, Muret Antike te qytetit Liss, Kisha e Shirgjit, Projekt konservimi e restaurimi Kalaja e Drishtit, Projekt konservimi dhe mirëmbajtje ne banesën Pashko Vasa, Shkodër, Xhamia e Allajbegise, Kisha-Xhami ne Kalanë e Shkodrës, etj.

**DRKK Korçë**, ka kryer punime mirëmbajtje, restauruese në 18 objekte Monument Kulture, Punime sistemimi e mirëmbajtje në Kishat në Voskopojë (Kisha e Shën Kollit, Manastiri i Shën Prodhomit, Kisha e Shën Marias, Kisha e Shën Ilias.) Punime mirëmbajtje në Kishat në Vithkuq (Kisha Shën Kozmai dhe Damian, Manastiri i Shën Pjetrit, Kisha e Shën Mehillit). Punime në pikturën murale në kishën e Shën Gjergjit Shipske, në kishën e Shën Nikollës Voskopoje, në kishën e Shën Thanasit Voskopoje, në Manastirin e Shën Prodhomit Voskopoje si dhe në pikturën murale në Manastirin e Shën Dhimitri Boboshticë.

Punime mirëmbajtje ne banesën e Sandri Qipros, Pogradec, mirëmbajtje në Muzeu i Arsimit ABC, në fasadën e Muzeu Arkeologjik, mirëmbajtje në Tuma e Kamenices, Varret Monumentale të Selcës, Pogradec, sistemime të territorit dhe pastrim nga bimësia Ura e Shën Prodhomit, etj.

#### **ZYRA E ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT BUTRINT**

Mirëmbajtje të objekteve specifike (monumente, pastrim vegetacioni, etj.), mirëmbajtjen e shtigjeve (pastrimi i vegetacionit të itinerareve turistike dhe shtigjeve mjedisore, pastrimi i pyllit, etj.) dhe të tjera në vlerë të përgjithshme prej 1,133,000 lekë.

## **ZYRA E ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI**

Mirëmbajtje e monumenteve, infrastrukturës së brendshme dhe promovim i parkut arkeologjik Apoloni.

- Janë kryer punime të mirëmbajtjes “Rifiksimit i tullave të shkëputura nga muret në 10 monumente”: *Tempulli Jonik, Prytaneoni, Harku i triumfit, Biblioteka, Odeoni, Dyqanet antike, Banesa me mozaik (D), Rruga H, Banesa me Impluvium dhe Hapja e Mozaikut të Vilës së Athinasë dhe ndërhyrjet në materialet konservuese të tij.*
- Pastrime të murit lindor fortifikues në gjithë trasenë e tij dhe portat hyrëse të tij.
- Krijimi i zonave të sigurisë përreth monumenteve ndaj rrezikut nga zjarret.
- Rrethimi i zonës së parkingut pranë hyrjes si edhe vendosja e sinjalistikës orientuese brenda zonës monumentale.
- Plotësimi i sinjalistikës dhe infrastrukturës muzeale dhe asaj ndihmëse/parandaluese në zonën e Qendrës Monumentale dhe përreth saj si edhe pranë biletarisë elektronike dhe manastirit.
- Broshura për vizitorët në tre gjuhë për të lehtësuar vizitën e tyre në park.

## **ZYRA E ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË PARKUT ARKEOLOGJIK BYLIS**

Punime të mirëmbajtjes dhe pastrim në të gjithë monumentet e vizitueshëm të parkut.

- **Përmirësimi i standarteve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në muzete dhe objektet e vizitueshëm të Trashëgimisë Kulturore / parqeve arkeologjik.**

### **Muze parqe të mirëmbajtura**

Aktiviteti kryesor i Muzeve Kombëtarë është promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve në funksion të saj. Një komponent i rëndësishëm është dhe pasurimi me fonde dhe përmirësimi i prezantimit përmes ekspozitorëve dhe përshkrimeve të objekteve në nivele bashkëkohore. Njëkohësisht pjesë e veprimtarisë së këtyre institucioneve janë edhe realizimet e veprimtarive dytësore si filmimet, fotografimet e objekteve muzeore nga subjekte të treta, si dhe riprodhimi i imazhit të objekteve të trashëgimisë kulturore, me qëllim ekspozimin e tyre, në kuadër të aktiviteteve të ndryshme.

**Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”**, përveç performancës lidhur me vizitueshmerinë ka realizuar dhe aktivitete të tjera promovuese me qëllim publikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si edhe në kuadër të Programit Edukimit mbi dhe përmes Kulturës, aktivitete me karakter edukues në bashkëpunim me shkollat e qytetit.

Janë organizuar ekspozita e konferenca, si ekspozita “Urtësi sot e mot”, ekspozita e fotografit Angjelin Nënshati, “Dëshmitar midis dy kohëve”, ekspozita e autores italiane Moira Ricci, “Lookaftering”, ekspozita Punëtorja “Made in Marubi”, Publikimi i librit “Ekspozitat e Marubi, konferenca “Arti Bashkëkohor dhe Trashëgimia Fotografike”. Një bashkëpunim mes Art House Muzeut Marubi, sollti për herë të parë në gjuhën shqipe përkthimin e njërit prej teksteve më të rëndësishëm për historinë e fotografisë, “Dhoma e Dritshme” e autorit Roland Barthes, përkthyer

në shqip nga Zef Paci. Hapja e ekspozitës “Nadar: Mes rregullave dhe tejava” Bisedë me temë Historia e Fotografisë: metodat e konservimit dhe restaurimit - franceze Anne Cartier-Bresson, Punëtorja- Guidat muzeore me shkollat profesionale të qytetit, etj.

Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, u prezantua me një ekspozitë në La Triennale di Milano, me tematikë “Arkiva Marubi: Rituali Fotografik” në La Triennale di Milano”, 16-19 dhjetor 2018 fondi i së cilës është miratuar me VKM Nr.186, datë 29.3.2018 *“Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve, pjesë të kalendarit për vitin 2018 si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriot Skënderbeut”.*

**Muzeu Historik Kombëtar**, Ka realizuar një sërë veprimtarish me karakter promovues, edukues në të gjithë pavijonet e këtij muzeu si dhe restaurimi i një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore pjesë e fondit të muzeut, ndërhyrjet konservuese të disa objekteve për mirëmbajtjen e tyre si dhe përfundimi i katalogut “Thesare nga Muzeu Historik Kombëtar”.

Aktivitete në nderim dhe përkujtim të figurave patriotike shqiptare si dhe në kuadër të programit “Edukimi mbi dhe përmes kulturës” u zhvilluan projektet edukative “Arkeologu i vogël”, Një pasdite në muze”, “Vizatoj historinë”, “Muzeu im” “Një orë leksioni në muze”, “Traditë dhe shije”, etj. Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut janë kryer një sërë vizitash dhe aktivitete nga nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qytetit, si dhe ekspozita lidhur me figurën e Heroit Kombëtar dhe epokës së lavdishme të tij, si Ekspozita “Moti i Madh”, 17 janar 2018, jeta dhe veprimtaria e Gjergj Kastriot Skënderbeut, “Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria 1916-1918” (Viti kulturor Austri-Shqipëri 2018, “Skënderbeu” me autor Gjovalin Paci, "Midis ëndrrës dhe realitetit" me autore Eliza Hoxha, “Jehona përmes shekujve- Gjergj Kastriot Skënderbeu”, me koleksionin e 37 librave të koleksionistes Patricia Nugee etj., Aktivitete në 18 maj, Dita Ndërkombëtare e Muzeve, Pjesëmarrje në panairin “Dite netët e librit”, me libra për figurën e Heroit Kombëtar, Ekspozita “Besëlidhja e lirisë 1878” në kuadër të 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ekspozita “Kongresi i Manastirit- Rruga drejt bashkimit ndërkombëtar” Ekspozita “Kruja dhe Skënderbeu”, me pjesëmarrjen e 50 artistëve që trajtojnë figurën e Skënderbeut në punimet e tyre. Konferenca shkencore dhe ekspozita “100 vjet gërmime arkeologjike në Shqipëri. Prezenca austro-hungareze në arkeologjinë shqiptare”. Ekspozita “Lugina e Vjosës në syrin tonë”.

Janë promovuar publikime të ndryshme si: promovimi i librit “Lufta e Kosovës”, Engjëjt e errësirës”, Korpusi i mozaikëve”, “ Skënderbeu në vendet nordike” Promovimin e librit “Naltësimi i Iskanderit” Promovimi i librit “Shqipëria dhe shqiptarët në arkivat spanjolle, ambasada e Spanjës Tiranë 1928-1939” etj. MHK kemi realizuar 2 botime, (në dorëshkrim) që janë fryt i një pune sistematike kërkimore, Hyrje në Muzeologji dhe Përmbajtja e Muzeut Historik.

Në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor vjetor ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës çelën në Prishtinë ekspozitën “ Unë jam Shqiptar”. Çelja e ekspozitës me titull “Shpirti arbëresh në veshje.

Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut u organizua ekspozita “Scanderbeg. Un eroe albanese in Puglia”, në ambientet e Muzeut Sigismondo Castromediano, Leçe, Itali, nga data 20 dhjetor 2018 – 3 shkurt 2019.

### **Muzeut Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë.**

Veprimtaria e këtij institucioni është përqendruar në pritjen e vizitorëve dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë ikonografike, që administrojnë ky muze. Gjithashtu dhe në aktivitete provuese dhe edukuese në kuadër Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut dhe programit Edukimi mbi dhe përmes Kulturës. Në bashkëpunim me shkollat 9 vjeçare, të mesme dhe universitetin, janë zhvilluar aktivitetet: “Skënderbeu në mite, gojëdhëna e tregime”, “Dashuria për natyrën”, “Kultura antike e vonë”, “Arti I shek. XVIII: Atelieja e Athanas dhe Kostandin Zografit”, “Arkeologjia eksperimentale”, “Epoka e neolitit ose Revolucioni neolitik” “Arti Ikonografik Shqiptar” “Motivet floreale në artin ikonografike “ etj. **Muzeu i Arsimit, Korçë**, në ambientet e tij janë zhvilluar aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore të krahinës së Korçës dhe të Shqipërisë, ku janë ekspozuar fotografi, dokumente, objekte të ndryshme, dhe janë shfaqur dokumentarë. Një nga ekspozitë interesante për publikun u organizua në 6 dhjetor 2018, në ambientet e Muzeut të Arsimit “Ekspozita me 6 këngët e gjetura së fundmi të riregjistruara në pllaka gramafoni të sopranos Tefta Tashko Koço” Gjatë kësaj periudhe nga specialistët e muzeut janë trajtuar objekte të ndryshme për pastrimin dhe konsolidimin e tyre, për t’i kthyer në gjendje të qëndrueshme dhe të ekspozueshme.

### **Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat,**

Për mbarëvajtjen e procesit të punës dhe mirëmbajtjen e objekteve janë kryer dezinfektimi i ambienteve dhe objekteve, kartelizimi dhe inventarizimi i objekteve të shërbesës me material druri, të inkorporuar brenda sallës qendrore të Katedrales “Fjetja e Shën Mërisë”. Konsolidimi dhe konservimi i disa objekteve për mirëmbajtjen e tyre, përgatitja e kartelave të reja për disa nga objektet e shtuara në koleksionin e Muzeut Etnografik gjatë vitit 2018, të dhuruara nga DRKK Berat, objekte në metal të grumbulluara gjatë ndërhyrjeve restauruese në vite të banesave në lagjet muzeale të Beratit. Përgatitje dhe përditësim informacioni, fletëpalosje në kuadër të sezonit turistik.

Janë realizuar një sërë aktivitete me karakter promovues, edukues mbi vlerat e trashëgimisë kulturore, pjesë e fondit të QKM-Berat. Projekti “*Artizanati dhe Brezi i Ri*”- Prezantimi, njohja e nxënësve me artizanatin Beratas, ekspozita “Arti i drugdhendjes të ushtruar nga një mjeshtër beratas”, së bashku me ekspozitën “*Muzeu në valixhe*”.

Në kuadër të 18 Prillit “*Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve, Ditës Botërore të Trashëgimisë Kulturore*” dhe vitit të kulturës Shqipëri-Austri, QKMB-ja prezantoi në pedonalen e qytetit të Beratit ekspozitën “*Pazaret mesjetare të Beratit*”, një cikël me 15 foto të vjetra të Qytetit të Beratit të viteve 1908 – 1940 të mbledhura nga Arkivat Austro – Hungareze. Organizimi i ëokshop-it me nxënësit, “Inventarizimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore”. Ekspozitat “*Muzeu Lëvizës*”, “*Tradita e veshjeve të gruas qytetare të Beratit dhe ceremonitë tradicionale përmes fotove*” në kuadër të 29 Shatorit dhe Ditëve Evropiane të trashëgimisë kulturore. Ekspozitë: “*Arkitektura tradicionale rurale në zonën nën-Pelister, Maqedoni*”, “*Different Festival Bach*”, ekspozita “*Arkitektura tradicionale e qytetit të Bitolës dhe rajonit të Bitolës*”

Në kuadër të programit “Edukimi përmes kulturës”, u hap ekspozita me 13 objekte nga koleksioni i Muzeut Etnografik, në Qendrën e Fëmijëve Autik “Shën Asti”, Berat, aktiviteti “*Atelier në Trashëgimin Kulturore*”. Në ansamblin historik të Kalasë në kuadër të javës së gjuhës dhe kulturës Italiane u zhvillua “*Maratona e artit dhe poezisë Italiane 2018*” me pjesëmarrjen e 14 shkollave të qytetit.

18 Maj “*Ditës Ndërkombëtare të Muzeve*”, Ekspozitë me 25 panele me imazhe të mjediseve dhe koleksionit të Muzeut Ikonografik ‘Onufri’. Njëkohësisht u zhvillua një guidë historike mbi



vlerat e këtij institucioni muzeor. U shpërndanë për të pranishmit materiale proporcionalë nga Muzetë e QKM Berat, si dhe u dhuruan bibliotekës së I E V P Berat një seri librash të grumbulluara nga specialistët e QKMB-së.

**Muzetë Kombëtarë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Etnografik, Krujë.** Fokusi kryesor i punës në të dy muzetë ka qenë ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i vlerave muzeore, si dhe mirëmbajtja e tyre. Ndër prioritet kryesorë ka qenë vizitueshmëria si dhe aktivitete me karakter promovues dhe edukues, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut dhe Programit Edukimi mbi dhe përmes Kulturës. Në bashkëpunim me bashkinë Krujë dhe shkollat 9-vjecare të qytetit të Krujës dhe qyteteve të tjera, janë zhvilluar aktivitete dhe Veprimtari letrare-artistike si “Banesa, Tradita, Zeje Ekspozita” Gjergj Kastrioti Skënderbeu përmes monedhës dhe pullës shqiptare”, “Mësoj dhe Argëtohem, me Skënderbeun”, “Dita Ndërkombëtare e Udhërrëfyesve Turistikë (21 Shkurt), “Përkujtojmë Kuvendin e Lezhës”. t si “Trashëgimia Kulturore Për Brezat”, “Në Rrugët e Skënderbeut”, “Muze që komunikojnë me të gjitha format, Qasje të reja, publik i ri, me nxënës të shkollave të rrethit Krujë”. Aktivitet i organizuar nga Delegacioni i BE-së, Bashkia Krujë dhe Muzeu “GJ K Skënderbeu” “Skënderbeu si figurë historike në mendimin evropian”, si dhe aktivitet me nxënësit e shkollave në kuadër të përfundimit të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut.

**Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë** ka kryer një sërë aktivitete me karakter promovues dhe edukues, si dhe aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historike-kulturore, ekspozita të artistëve të rinj, promovime librash, me fokus kryesor promovimin e trashëgimisë sonë kulturore dhe vlerave muzeale. Aktivitet me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së Ismail Qemalit, etj.

**Muzeut Kombëtar “Gjethi”** është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore që mbart ky institucion, si dhe pritjen e vizitorëve, me qëllim njohjen dhe ndërjegjësimin e brezit të ri mbi të kaluarën komuniste u zhvillua projekti “Kujtojmë për të mos harruar”, dhe “Mbresa”, ekspozitën "Rruga e Shqipërisë në Komunizëm", si dhe ka marrë pjesë në konferencën me temë "Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë" në Përballje me të Kaluarën. Ekspozita dhe konferenca u mbajtën në Muzeun Municipaliul Palatul Sutu, Bukuresht, e cila do të qëndroi e hapur deri më datë 15 shtator 2018. Pjesëmarrje në konferencën “Meet, see, do” organizuar nga BMN ( Balkan museum Netëork), Aktivitet përkujtimor për kompozitorin Lec Kurti. Shtigje rinore, organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Muzeu Kombëtar "Gjethi" si institucion bashkëpunues. Eventi u promovua nga sopranoja shqiptare njëkohësisht dhe atashe kulturor i Ambasadës shqiptare në Bukuresht: znj. Arlinda Morava.

Gjatë muajit nëntor në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar u zhvillua trajnimi “Riorganizimi i koleksioneve muzeale sipas metodologjisë Re-Org” në sajë të bashkëpunimit mes disa institucioneve si ICOM, ICCROM, ICOM Albania, MHK, MK, me pjesëmarrjen e stafeve të muzeve kombëtarë ky trajnim kishte në fokus mbrojtjen e fondeve muzeore, organizimin e tyre.

**Zyra e Administrim dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Apoloni** ka ndërmarrë disa ndërhyrje emergjente mirëmbajtje të cilat ishin të paevitueshme.

-Ndërhyrja në çatinë e portikut të muzeut pas dëmtimit të gjithë pjesës lindore të tij nga stuhia e forte që ndodhi në këtë zonë. Ndërhyrja u realizua nga ana e stafit të ZAKPA Apoloni dhe firmës AD STAR e cila ka realizuar edhe projektin e Manastirit.

-Konsultim me ekspertët e IMK-së për situatën kritike të murit të Temenosit por edhe për murin rrethues të Manastirit. U realizua pastrimi i vegjetacionit të këtyre dy zonave për të bërë një studim më të detajuar për ndërhyrjet restauruese e nevojshme.

-Marrja e ikonës triptike nga ana e grupit të punës të kryesuar nga përgjegjësi i sektorit të Artit në IMK z. Agron ISLAMI për të realizuar ndërhyrjen konservuese të saj në laboratorin e IMK-së.

Kanë vazhduar paralelisht pastrimet periodike nga vegjetacioni në monumentet e parkut arkeologjik. Karakteri i punimeve është i lidhur me mirëmbajtjen e monumenteve dhe ambienteve rreth tyre. Është prerë vegjetacioni në sektorin e manastirit dhe në hapësirën jashtë tij duke bërë prerje masive në tarracën perëndimore dhe në sektorin e murit lindor jashtë manastirit. Pastrimi i monumenteve nga vegjetacioni vazhdoj në sektorin e agorasë ku kërkohet pastrim të vazhdueshëm në periudhën e lulëzimit të vegjetacionit. Paralelisht është bërë pastrimi dhe evakuimi i mbeturinave jashtë parkut arkeologjik.

Pastrimi i monumenteve nga vegjetacioni u realizua në gjithë monumentet e agorasë: Bouleterioni, Magazinat, Bibloteka, Stoa A, Stoa B, Muri i Amforave, Muri i Temenosit, Prytaneoni, Tempulli Jonik, Faltore A, Faltore B, Cisterna dhe Magazinat si edhe në territorin përreth monumenteve, gjithashtu dhe në Murin rrethues të anës lindore në sektorin midis dy portave, Banesa me Impluvium, Rruga H dhe kulla e rrumbullaket në hyrje të parkut arkeologjik. Në kuadër të ditëve ndërkombëtare të trashëgimisë me fokus në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të sitit, në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” dhe projekteve të bashkëpunimit ka organizuar 3 aktivitete.

“Ciceroni i Vogël”, dhe trajnimi dy ditor “Cicerion apo Pasqyrë” të zhvilluar në kuadër të nismës së Ministrisë së Kulturës “Edukimi përmes kulturës”.

Aktivitetet janë realizuar me Qendrën Rinore “Epoka e Re” si dhe shkollat publike dhe jopublike të qytetit të Fierit, Janaq Kilica, Flatrat e Dijes, Dertliu, Perikli Ikonomi, Andon Xoxa etj në kuadër të bashkëpunimit me institucionin e DAR-it Fier për 18 prillin, 22 prillin dhe sidomos aktivitetet edukative dhe argëtuese.

Flashmob i realizuar në 22 prill ( Dita e Tokës) në moton “ Të mbrojmë natyrën dhe monumentet” në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Epoka e Re” dhe “Lulekuqet e Dancit” Fier. Ndezja e Flakës Olimpikë e realizuar nga shkolla “Muco Delo” e cila në bashkëpunim me ZAKPA Apoloni realizuan një ceremoni antike.

### **Zyra e Administrim Koordinimit Butrint**

3 aktivitete të organizuara në kuadër të ditëve ndërkombëtare të trashëgimisë me fokus në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të sitit, në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” dhe projekteve të bashkëpunimit

- “Reconnect - Bashkëpunimi rajonal për zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemeve detare” Organizatorë: Fakulteti i shkencave të natyrës, ZAKB, Prefektura Vlorë, Sipa Tours, Policia e Kufirit, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Bashkia Konispoli, Bashkia Sarandë, ndërkufitare.

Objektivi i përgjithshëm i projektit RECONNECT: Pasqyrimi i problemeve të përbashkëta të kërcënimeve mjedisore dhe përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve menaxhuese, duke promovuar menaxhimin efikas të burimeve natyrore përmes bashkëpunimit ndërkufitar.

Qëllimi: Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërkombëtar midis ekosistemeve të kërcënuara të Zonave të Mbrojtura Detare (ZMD) dhe zonave “*Natura 2000*” të Greqisë, Qipros, Bullgarisë dhe Shqipërisë, të cilat do të zbatojnë një strategji të përbashkët të ruajtjes.

- Aktivitetet në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” si: “Ju dhe fytyrat nga lashtësia” me pjesëmarrjen nxënës të shkollës 9-vjeçare Mursi dhe Xarrë, të cilët u njohën me artin e portretit në shekuj si dhe zhvilluan një lojë eksperimentale të të kuptuarit të portretit, nëpërmjet portreteve të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik Butrint. Kafshët e mozaikut të dyshemesë së Baptisterit me pjesëmarrjen e nxënësve të Shkollës 9-Vjeçare “5 Dëshmorët” Ksamil.

**Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Bylis**, janë kryer pastrimet periodike nga vegjetacioni në monumentet e parkut arkeologjik, punimet kryhen me objektiv mirëmbajtjen e monumenteve dhe ambienteve rreth tyre. Gjithashtu janë zhvilluar disa aktivitete si: Bisedë e hapur me nxënës të Shkollës së mesme Panahor dhe shkollës së mesme Hekal. Takim dhe bisedë e hapur me nxënësit e shkollave në kuadër dhe të programit "Edukimi përmes kulturës" dhe specialistë të fushës mbi vlerat e mëdha të trashëgimisë kulturore të sitit të Bylis si ndër më të lashtët në rajon.


## **VIZITUESHMËRIA NË INSTITUCIONE DHE QENDRA TË TRASHËGIMISË KULTURORE JANAR – DHJETOR 2018**

Në relacionin në vijim janë paraqitur dhe analizuar të dhënat statistikore të vizitueshmërisë për periudhën Janar – Dhjetor 2018 në raport me periudhë Janar – Dhjetor 2014 - 2017.

### **I. Vizitueshmëria në periudhën Janar – Dhjetor 2018**

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë 12- mujorit (janar – dhjetor) 2018 janë vizituar nga **998,441** vizitorë vendas dhe të huaj, nga të cilët **331,940 në** Muzetë kombëtarë, **337,845** në parqet arkeologjike dhe **308,656 në** monumente të kulturës.

**Analiza e të dhënave mujore të vizitueshmërisë dëshmon** trendi i vizitueshmërisë në gjashtë mujorin e parë shënon pikun më të lartë në muajin maj, ndërsa në 6-mujorin e dytë në muajt gusht dhe shtator, një tendencë e përsëritur edhe nga vitet e kaluara 2016-2017. Grafiku si më poshtë:



**Analiza krahasuese e të dhënave statistikore për periudhën Janar-Dhjetor 2017 dhe 2018 dëshmon se trendi i vizitueshmërisë ka shënuar rritje. Periudha janar – dhjetor 2018 shënon 329,331 vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2017 dhe 448,744 vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2016.**


**Trendi i vizitueshmërisë (vizitorë në total) në periudhën janar – dhjetor në vitet 2014-2018 (në %)**

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017, vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **49%**.


Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **82%**.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **115%**.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **127%**. Grafiku si më poshtë.



Trendi i rritjes progresive vihet re edhe në kategorinë e vizitorëve me biletë dhe të ardhurat e gjeneruara nga institucionet dhe qendrat e vizitueshme. Grafiku më poshtë:



Rritja e numrit të vizitorëve ka bërë dhe rritjen e të ardhurave nga biletat të cilat mund të përdoren në mirëmbajtjen e Monumenteve të Kulturës, Parqet Arkeologjike dhe Muzetë Kombëtarë si dhe për të përballuar detyrimet për ruajtjen e objekteve apo çdo detyrim tjetër që lidhet me to. Nisur nga sa më sipër Ministria e Kulturës kërkon dhe rritjen e limitit të përdorimit të të ardhurave nga institucionet tona. Pasi aktualisht limiti i përdorimit të të ardhurave nga institucionet është

Trendi i vizitueshmërisë në rritje progresive për periudhën janar – dhjetor 2014 - 2018 sipas kategorive të institucioneve dhe qendrave të vizituara është dhënë sipas grafikëve më poshtë



Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore të vizitueshëm me biletë, gjatë sezonit turistik, krahas **performancës së përmirësuar dhe shërbim me standarde**, janë hasur dhe me:

#### Vështirësitë:

- Staf i kufizuar në numër për përballimin e fluksit turistik në institucione dhe qendra të artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Mungesa e guidave punëtoreve të mirëmbajtjes dhe biletashitësve për të përballuar fluksin e vizitave turistike me orare të zgjatura dhe pa ditë pushimi.
- Mungesa e punonjësve të pastrimit.
- Oraret e tej zgjatura pa ditë pushimi për stafet e institucioneve.

#### Bashkëpunimi ndër-institucional

- Masa të marra në kuadër të vlerësimit të problematikave të përcjella nga shoqata shqiptare e tur-operatorëve dhe agjencive turistike.
- Poster anti-korrupsion me numër jeshil të lidhur me sekretarinë e Ministrit të Kulturës vendosur në çdo biletari të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe artit në varësi të MK për denoncime të rasteve të evidentuara të abuzimit dhe korrupsionit.

- Janë prokuruar dhe vendosur 11 kasa fiskale, kompjuter dhe printer në 11 institucione të artit dhe trashëgimisë kulturore

#### **Analizë e burimeve**

- Pamjaftueshmëri e kapaciteteve njerëzore në pritjen dhe përballimin e fluksit të turistëve.
- Mbingarkesë e stafëve aktuale të institucioneve të artit dhe trashëgimisë për të mbuluar me personel të dedikuar orarin e zgjatur të vizitueshmërisë.

**Masa shtesë: Promocion.** Në kuadër të sezonit turistik veror dhe mbarëvajtjes së tij, Ministria e Kulturës dhe Institucionet e trashëgimisë kulturore kanë prodhuar dhe shpërndarë materiale promocionale të siteve dhe institucioneve të vizitueshëm (fletëpalosje, udhërrëfyes, etj.) në disa gjuhë të huaja.

#### **Nevojë e domosdoshme:**

Shtesë personeli me kohë të pjesshmen në të gjithë institucionet e artit dhe trashëgimisë kulturore të vizitueshëm gjatë sezonit turistik veror.

- **Promovimi i vlerave të trashëgimisë shpirtërore, materiale dhe diversitetit kulturor përmes zhvillimit të 70 veprimtarive të përvitshme.**

#### **Aktivitete, veprimtari kulturore**

Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të trashëgimisë kulturore kanë organizuar një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara in-situ ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës.

#### **AKTIVITET E TRASHËGIMISË JOMATERIALE NË VITIN 2018**

Projektet me Thirrje për vitin 2018 të TJ : 29 projekte të miratuara, nga të cilat  
 8 të dedikuara për Programin Kombëtar “*Edukimi përmes kulturës*”,  
 7 dedikuar artizanatit dhe kulinarisë,  
 5 festivale  
 5 aktivitete multikulturore  
 4 të ndryshme.

#### **Projektet me Thirrje (AKTIVITETE TË NDRYSHME) :**

1. Realizuar projekti “*Traditë Arti Kulturë*”- *Çelsat e ruajtjes së Trashëgimisë*”, Shoqata CESVI në qytetin e Përmetit
2. Festivali Ndërkombëtar Folklorik “*Aulona Inter Folk Festival*”, edicioni i 10-të zhvilluar në qytetin e Vlorës
3. Festivali i 15-të Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të vegjël popullorë, zhvilluar në qytetin e Fushë Arrëzit
4. Projekti “*Java e Ali Pashës*”, zhvilluar në qytetin e Tepelenës
5. Projekti i Festivalit Përmeti Multikulturor 2018, u organizua nga Seksioni Shqiptar i CIOFF-it në qytetin e Përmetit

6. Projekti **“Panairi veror i artizanatit dhe zejtarisë në Velipojë”** u organizua nga Shoqata e Artizanëve dhe Punimeve Artistike të Shqipërisë në 7 korrik në qytetin e Velipojës
7. Projekti **“Vera Kulturore Maqedonase”** u organizua nga z. Edmond Sotir në Pustec
8. Projekti **“Lirika e Divanit lunxhjt”** u zhvillua nga Qendra Rajonale “Syri i Medias së Re” në fshatin Dhoksat
9. Projekti **“Brumi i jetës”** u zhvillua nga Shoqata “Miqësia” në qytetin e Gjirokastrës
10. Projekti **“Realizimi i Shtëpisë Muze- Rijetezimi i figurës së Artistit te Popullit Usta Laver Bariu”**.
11. Projekti **“Harta digjitale e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”** zhvilluar në periudhën Prill-Tetor, në Tiranë. Krijimi i hartës digjitale të qytetit të Përmetit.
12. Projekti **Festivali Mbarëkombëtar “Oda Dibrane”** zhvilluar në qytetin e Peshkopisë
13. Projekti **“Turizmi Kulturor Bregdetar nëpërmjet Inovacionit”**
14. Projekti **“Sirenat kulturore përgjatë rrugës joniane ekspozohen në bregdet”**
15. Projekti **“Takimi i Lahuritarëve, Festivali i Këngës Epike dhe Lirike”** edicioni IV, Mat,
16. Projekti **“Artizani”**
17. Projekti **“Frymëzime nga shtëpitë-legjendë të Gjirokastrës”** zhvillohet nga Shoqata “Open Doors” në qytetin e Gjirokastrës
18. Projekti **“Kostumet shqiptare, Fustanella dhe Xhubleta”**
19. Projekti **“Rrugët e besimit-Gjurmë Bashkjetese”**
20. Projekti **“Muzeu i Stilit Etno-Vibe”**, u zhvillua nga Qendra Kulturore “Ti” në Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi” Shkodër, në 28- 29 shtator.
21. Projekti **“Kolonja Folklor dhe fotografi në xham”** zhvillohet në qytetin e Kolonjës në 10-12-14 dhjetor. Përbante shfaqje folklorike, ekspozite fotografike.

### **Projekte me Thirrje (EDUKIM)**

1. Projekti : **“Edukimi përmes valles tradicionale të brezit të ri”**, zhvillohet nga koreografi Bardhyl Pojani në qytetin e Korçës,
2. Projekti : **“Edukimi përmes këngës gjirokastrite të brezit të ri”**, zhvillohet nga këngëtari Roland Çenko në qytetin e Gjirokastrës
3. Projekti **“Edukimi i fëmijëve përmes trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale”**, zhvillohet nga znj. Ariana Todhe në qytetin e Përmetit,
4. Projekti **“Së bashku për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore tek brezi i ri”**, organizuar nga Shoqata “Aks” dhe zhvilluar më 24-25 maj ne qytetin e Librazhdit.
5. Projekti **“Simbolika e plisit dhe prodhimeve me teknikat e vjetra artizanale shqiptare”** u zhvillua nga znj. Anila Zajmi në maj-qershor.
6. Projekti **“Rijetëzimi i trashëgimisë së luleve të traditës-ndikon në edukimin e të rinjve dhe turizmin mjedisor”** zhvillohet nga z. Ali Delialaj në qytetin e Permetit
7. Projekti **“Takim Brezash”**, organizuar nga Fondacioni “Tradita Popullore” Kashar, zhvilluar në periudhën maj-qershor në qytetin e Tiranës.
8. Projekti **“Ne dhe trashëgimia kulturore, traditat, legjendat pranë shkollës”**, organizuar në qytetin e Tiranës nga Qendra për Promovimin e Konkureshmërisë.

### **Projekte të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës:**

1. Realizimi i **Ekspozitës me koleksionet e znj. Patricia Nugee**, në Muzeun Historik Kombëtar

## **2. Projekti i Promocionit**

3. Projekti “**Legjendat Shqiptare në Novelat Grafike**“ edicioni 4, u zhvillua në datë 15.11.2018, në sallën dhe hollin e Teatrit ArTurbina
4. Projekti realizimi ne versionin audio te përrallës “**Përrallat e Ptilushes**“ nga Rudina Xhunga për fëmijët që nuk shikojnë. Realizim CD me 11 përralla dhe 1 tregim.
5. Projekti “**Promovimi i vlerave te trashëgimisë kulturore për vitin 2019**“.
6. Projekti “**Botimi i Albumit fotografik**“ i autorit Fation Plaku,

## **Projekte të Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike:**

1. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare, Elbasan 2018.
2. Edicioni i X-të i FFTK të Sazeve, në Pazarin e Vjetër, Korçë.
3. FFTK i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë, Lezhë 2018
4. Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore 29 shtator, “Etno Spirit”
5. “Alb Fest” Shëngjin, 2018.
6. “Një ditë me traditën”, Kavaje, Durres
7. Festivali “Rit Brum Fest”, Gjirokastrë

## **Projekte të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Kulturës , Muze Kombëtar, IMK, DRKK, Parqe Arkeologjike, etj.**

### **- Bienale e Arkitekturës Venecia 2018**

Pjesëmarrja e Shqipërisë në edicionin e 16-të të ekspozitës ndërkombëtare të Arkitekturës, Bienale e Venecias, 25 maj – 26 nëntor 2018, Arsenale, Venecia, Itali.

DPZHK përgatiti dhe ndoqi të gjitha fazat e procesit selektiv të projektit fitues “Zero Space” që përfaqësoi Shqipërinë në këtë event të rëndësishëm ndërkombëtar si dhe përgatiti, ndoqi dhe monitorojë pjesëmarrjen e Delegacionit të Ministrisë së Kulturës në këtë aktivitet dhe të aktivitetit të ekipit kuratorial gjatë kohëzgjatjes së ekspozitës.

Pavijoni shqiptar me projektin “Zero Space” i kuruar nga “Varka Arkitektur” u inaugurua më datë 25 maj 2018 në Arsenale di Venezia, në prani të personaliteteve dhe vizitorëve të shumtë shqiptarë dhe të huaj, pas një punë përgatitore disa mujore. Pavijoni shqiptar në “La Biennale di Venezia” qëndroi i hapur për publikun deri më 25 nëntor 2018, dita e mbylljes së Bienales.

Ky ishte prezantimi i pestë i Shqipërisë në ekspozitën ndërkombëtare të Bienales të Venecias që nga viti 2014.

Ekspozita e 16-të Ndërkombëtare e Arkitekturës “Bienale e Venecias” tërhoqi interes të me mbi 275,000 vizitorë, duke shënuar një rritje prej 6% krahasuar me 260,000 vizitorë të vitit 2016.jashtëzakonshëm dhe një numër të madh vizitorësh.

### **- 60 vjetori i Anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO / në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut**

Në kuadër të 60 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) më 16 tetor 1958, me iniciativë fillestare nga Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë UNESCO-s, pranë MEPJ, Grupi Ndërministror, i përbërë nga nëpunës të MEPJ, MK, MASR dhe MTM, propozoi një program aktivitetesh.

Ministria e Kulturës luajti rolin kryesor në këtë program. Kështu u zhvilluan aktivitetet:



**Konferenca “Shqipëria – 60 vjet në UNESCO”, 16 tetor 2018, Tiranë.**

**Ekspozita ikonografike “A Ēindoë in Albanian Medieval Art”, 19 nëntor 2018, në sallat “MIRO” të Selisë Qendrore të UNESCO-s në Paris.**

**Botime promocionale në gjuhën angleze;** Broshura “*Albania 60 years in UNESCO*”, me materiale tekstuale përshkruese dhe foto mbi fusha dhe aspekte të ndryshme të bashkëpunimit 60 vjeçar Shqipëri- UNESCO; Katalogu i ikonave “*A Ēindoë in the Albanian Medieval Art*” me foto tepër cilësore të ikonave të paraqitura në Ekspozitën në UNESCO dhe të dhëna deskriptive për to; Fletëpalosje me sitet e pasuritë kulturore shqiptare në listat dhe regjistrat e ndryshëm të UNESCO- s, dhe evente kryesore në kuadër të këtij 60 vjetori.

- **Ekspozita “Arkiva Marubi: Rituali fotografik” në La Triennale di Milano organizuar nga Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”;** Ekspozita u realizua në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut, në data 16 nëntor- 9 dhjetor 2018, në hapësirën e La Triennale di Milano kuruar nga artisti Zef Paci, me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shqiptare në Itali përmes materialeve fotografike të arkivës “Marubi”.
- Gjithashtu dhe një sërë aktivitetesh të raportuara nga institucionet e fushës në kuadër programit Edukimi përmes Kulturës, Takohemi për një libër, Arkeologu i Vogël, Miku i Monumentit. Aktivitete të zhvilluara nga IMK; QKIPK; muzetë kombëtarë; parqet arkeologjike; DRKK-të, etj.
- **Inventarizimi i 5000 objekteve dhe/ose elementeve të trashëgimisë jomateriale dhe pajisja me kartelë teknike**

Objekte të inventarizuara

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore në përmbushje të misionit të saj për dokumentimin e saktë shkencor të pasurive kulturore, inventarizimin, ruajtjen, katalogimin informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar në databazën kombëtare të pasurive kulturore, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, ruajtjen, studimin, botimin dhe promovimin e tyre, si dhe në zbatim të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të lidhura me të, ka hartuar dhe realizuar “Planin Operacional 2018” duke përcaktuar objektivat dhe produktet bazuar në tre shtylla kryesore:

- A. Krijimi dhe përditësimi i Regjistratit Kombëtar të Pasurive Kulturore përmes Sistemit Informatik Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore
- B. Kontrolli i lëvizjeve të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe monitorimi i respektimit të të drejtave të pronësisë
- C. Antitrafiku i pasurive kulturore (Lufta kundër trafikimit të pasurive kulturore dhe administrimi i databases së objekteve të humbura)

Aktivitete të organizuara nga institucioni për periudhën: Janar-Dhjetor 2018.

**- Janar- Dhjetor 2018**, rezultojnë të regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.278 dt.16.05.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore”. - Gjithsej **77,192** objekte.

- **74,154** Objekte në pronësi Shtetërore.
- **3,038** Objekte në pronësi Private.

Është ndërtuar Sistemi për indeksimin e regjistrave themeltar të fondeve muzeore dhe ndërveprimin për hedhjen e të dhënave në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”. Janë digjitalizuar 24 Regjistra themeltar të fondit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “MARUBI”, total 16,583 faqe të digjitalizuar dhe indeksuara.

Për periudhën **Janar –Dhjetor 2018**, ka përfunduar hedhja e të dhënave për 10 Regjistra themeltar në total **72,582** objekte të importuara në sistem, si dhe **6,887** faqe të përfunduara digjitalizuar/indeksuara.

Monitorimi i lëvizjeve, Qarkullimi kombëtar/ndërkombëtar i objekteve.

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore në zbatim të Ligjit nr.27/2018 “Për Trashëgimin Kulturore dhe Muzetë”, monitoron, regjistron, asiston në procedurat e ndryshme të qarkullimit kombëtar/ndërkombëtar të objekteve pjesë e pasurive kulturore, Përgjatë periudhës **Janar-Dhjetor 2018**, janë kryer procedurat e regjistrimit në RKPK të Transaksione/Leje për **4,195** objekte pjesë e Pasurive Kulturore.

1. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.278 dt.16.05.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, është vendosur që Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore është institucioni i vetëm administrues i kësaj databaze, krijuar përmes projektit “Krijimi i Qendrave të Informimit Publik për Regjistrimin On-Line të Pasurive Kulturore”, i përfunduar dhe marrë në dorëzim në Shkurt 2018.

Projekti bëri të mundur:

- Krijimin e Sistemit Informatik Kombëtar i Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore dhe Bazës së të dhënave shtetërore për regjistrimin e Pasurive Kulturore materiale dhe jomateriale për të gjitha kategoritë e poseduesve, me qëllim identifikimin, katalogimin, ruajtjen dhe përdorim nga:
- Institucionet Shtetërore, Subjektet Private (Fizike/Juridike) që posedojnë dhe administrojnë Fonde të Pasurive Kulturore në sistemin e trashëgimisë kulturore dhe të turizmit, për krijimin dhe përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore në pronësi publike dhe private, si dhe për administrimin e Inventarit të Fondit Muzeor Kombëtar.
- Shërbimi doganor në Republikën e Shqipërisë për monitorimin e lëvizjeve dhe të pronësisë së objekteve të pasurive kulturore, në pronësi publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të RSH.
- Policia e Shtetit / Interpoli për shkëmbim informacioni në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend, si dhe në rastet e denoncimeve nga Institucionet Ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë RSH.

- Publiku për informim mbi procedurat e regjistrimit të pasurive kulturore kombëtare në pronësi private dhe publike, procedurat e lëvizjes brenda dhe jashtë territorit të RSH për objektet trashëgimi kulturore, si dhe për informacion mbi Pasuritë Kulturore Kombëtare.
- Ndërtimin e kabinetit të serverëve në parametra dhe standarde ndërkombëtare.
- Krijimin dhe vënien në funksion dhe strukturë të 6 Qendrave të Informimit Publik për regjistrimin online të pasurive kulturore kombëtare pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, si Zyra rajonale të QKIPK-së për dokumentimin, inventarizimin dhe katalogimin e pasurive kulturore, monitorimin e lëvizjes, si një strategji kombëtare në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore.
- Krijimin e sportelit të shërbimit publik pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore për informacion dhe kryerjen e procedurave të regjistrimit.
- Lehtësimin e procedurave për shërbim publik ndaj qytetarëve lidhur me regjistrimin e veprave të artit dhe të objekteve të trashëgimisë kulturore në pronësi të tyre si dhe publikimin e pasurive kulturore shqiptare.
- Ndërveprimin në Gov-net për ofrim dhe marrje shërbimi.

### **3. Programi "ART DHE KULTURA"**

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/leke

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi ne (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
				Ne mije leke	Struktuarane %	Ne mije leke	Struktuarane %	
12	08230	600-601	Shpenzime Personeli	520,522	35.54%	516,717	35.64%	99.27%
12	08230	602-606	Shpenzime Korrente	284,276	19.41%	273,923	18.89%	96.36%
12	08230	230-231	Shpenzime Kapitale	660,000	45.06%	659,184	45.47%	99.88%
		<b>Totali</b>		<b>1,464,798</b>	<b>100%</b>	<b>1,449,824</b>	<b>100%</b>	<b>98.98%</b>

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 98.98% ndaj planit për 12-mujorin e 2018. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 35.54 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99.27 % ndaj planit për 12 mujorin e 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 19.41 % të totalit dhe janë realizuar në masën 96.36 % ndaj planit për 12

mujorin e 2018. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 45.06 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99.88 % ndaj planit për 12 mujorin e 2018.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në katër produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Kodi i Programit	08230	Emertimi i programit:	Arti dhe Kultura						
Qellimi I	Politika e programit synon nxitjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave kulturore Kombëtare brenda vitit 2020 nepermjet: Përmirësimin në vijimësi të infrastrukturës dhe shërbimeve në institucionet kulturore në vend; Nxitjen dhe mbështetjen e gjeneratës së re dhe krijesve në art kulturë duke respektuar barazinë dhe integrimin gjinor në zhvillimin e veprimtarisë artistike të tyre brenda dhe jashtë vendit; Zhvillimin e audiencave dhe edukimin kulturore të shoqërisë, si dhe Edukimin mbidhe përmes arteve të brezave të rinj. Përfaqësimin e produkteve kulturore elitare shqiptare në aktivitete dhe programe ndërkombe të								
<b>**Treguesit e performancës/P produktet:</b>									
*Objektivat e politikës *	Kodi i Treguesit të Performances/P produktit	Emertimi i Treguesit të Performances ***/P produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin kovent	Niveli i rishikuar në vitin kovent	Niveli i planifikuar për periudhën progresive	Niveli faktik në fund të vitit kovent	% e Realizimit të Treguesit të Performances/P produktit	
<i>Objektivi I1</i>	Zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në institucionet kulturore në vend, nepermjet realizimit të investimeve përmes projekteve të Teatrove "Skena e Re" dhe TKOBAP, QKKF dhe rikonstruksionin e 2 Teatrove Vendojë								
	A	Ndërtimi dhe rikonstruksionin e infrastrukturës në nivel qendror	484,915	450,000	450,000	660,000	659,184	100%	
<i>Objektivi I2</i>	Pasurimin në masën 4 % të programacionit dhe kalendareve artistike në institucionet e artit dhe sektoreve kreative të skenës së pavarur, duke respektuar parimet e barazisë gjinore, krahasuar me vitin 2017								
	B-C	Veprimtari të realizuara me fondet e programit art kulturë sipas prioritetëve dhe integritetit gjinor	733,129	739,149	742,649	779,398	765,240	98%	
<i>Objektivi I3</i>	Rritjen e bashkëpunimeve dhe perfaqësimeve të artit dhe artistëve shqiptar në aktivitete dhe skenë								
	D	Perfaqësimin jashtë vendit në programet komunitare, programet e bashkëpunimit, perfaqësimeve në festivale, panaire, rezidenca etj	33,720	25,400	25,400	25,400	25,400	100%	

### **Produktin (A): Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore**

Në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi;

- Teatri i ri Turbina, me dy skena, dhe platforma multi funksionale arti (Inauguruar 2018)
- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proces.

### **Produkti (B): Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës**

Në institucionet e artit janë zhvilluar aktivitete të shumta artistike, në gjinitë dhe fushat respektive. Institucionet e artit, përveç kalendarit sezonal të miratuar me Bord Artistik, kanë bashkëpunuar disa eventeve në partneritet ndërinstytucional, Ambasada, Institucione homologe, etj. Referuar pasqyrës financiare në programin “Art-Kulturë” ky fond kryesisht është mirë menaxhuar nga Institucionet e Artit dhe Drejtoria e Përmbajtjes në Ministri. Drejtoria ka zhvilluar një marrëdhënie intensive shkresore por edhe informale me përfaqësues të institucioneve të artit, në bashkërendimin dhe lehtësimin e praktikave specifike me këto institucione. Drejtoria, koordinon dhe përpunon të dhënat statistikore për çdo muaj, për nr. e premierave, projekteve, audiencës për këto institucione, të cilat i raporton edhe në rrugë zyrtare pranë KM dhe INSTAT.

### **Produkti (C): Veprimtari të realizuara me fondet e programit art-kulture**

“Krijimtaria artistike dhe industrinë kulturore”: Në qendër të këtij produkti është zhvillimi i platformave dhe modeleve të reja kulturore për zhvillimin e skenës së pavarur dhe nismave të brendshme të veçanta, duke përzgjedhur dhe propozuar politika dhe mekanizma favorizuese që kanë në fokus promovimin e industrive kulturore. Ky produkt vjen si rezultat i mbështetjes së projekteve në dy drejtime:

**Projekte me thirrje:** Për vitin 2018 janë vlerësuar dhe mbështetur nga një Kolegji i posaçëm në MK, rreth 82 projekte fituese nga Ministria e Kulturës, mes 300 projekteve konkurruese në vlerën Total 45.000.000 lekë.

- Tipare kyçe të projekteve fituese, kanë qenë: projektet dhe eventet; prodhime kulturore letrare artistike; hulumtim dhe zhvillim; që sigurojnë përfshirje dhe punësim, zhvillim dhe edukim audiencash, vepra dhe projekte artistike kulturore me karakter shëtitës, Inovacioni, Edukimi përmes Kulturës, Kreativiteti, etj.
- Disiplinat e aplikuara janë: Teatër, Muzikë, Dokumentar filmik, Ekspozita bashkëkohore dhe Koloni Arti, Festivale Filmi, Teatroshtet si dhe Botime të ndryshme.

- Përfituesit kryesorë të këtyre projekteve, janë individ dhe organizata, kryesisht artist, kurator, shkrimtar, producentë, promovues të art - kulturës, si dhe te tjerë që artin dhe kulturën i kanë të përfshira në veprimtaritë e tyre.
- Target grupet kryesore që u janë drejtuar projektet përfituese për vitin 2017, janë: Audienca e gjerë, kritika / studiues të artit, brezi i ri dhe grupet vulnerabël.

**Projekte të Brendshme:** Drejtoria, ka udhëhequr dhe ka hartuar rreth 40 praktika - projekte të posaçme në kuadër të kalendarëve dhe bashkëpunimit kulturor në nivel institucional dhe ndërinstitutional:

- Drejton dhe harton në të gjitha fazat e saj, praktikën e projekteve me thirrje (Udhëzim: Rregullore Kolegjiumi; Procesverbale, Vendime; Urdhër për financim) etj.
- Viti Skënderbeu-ngjarje vjetore me karakter shtetëror: U realizuan: Konkursi i Krijimtarisë Muzikore / Turizmi Kulturor dhe Diaspora nga (TKOBAP)/ Festivali Mbarëkombëtar i Teatrove, etj.
- Kalendarin Turistik Kulturor:
- Programin Kombëtar për Edukimin;
- Kalendarin e përbashkët Kulturor Shqipëri-Kosovë;
- Viti i Kulturës Shqipëri Austri;

Janë ndjekur, monitoruar dhe bashkërenduar puna për 100% të projekteve, të cilat kanë angazhuar një fondin e parashikuar në masën 100% të fondit vjetor dedikuar thirrjes së projekteve. Procesi i mbarëvajtjes deri në mbylljen e plotë të detyrimeve kontraktore ndiqet dhe monitorohet nga nëpunës së Drejtorisë sipas profilit të tyre profesional. Duke marrë në konsideratë zhvillimin të këtyre aktiviteteve në një shtrirje gjeografike në mbarë vendin dhe më së shumti në sezonin veror, kryesisht në qendra dhe site të trashëgimisë kulturore në gjithë hapësirën e vendit, Drejtoria ka koordinuar punën për monitorimin e projekteve edhe nga specialistë të drejtorive rajonale në rrethe.

Projekte me inicim të Drejtorisë dhe Strukturave të Përmbajtjes në MK, bazuar në prioritet strategjike: Bashkëpunon dhe koordinon mes MAS-MK, përgatitjen e qarkoreve për DAR Tiranë dhe rretheve për realizimin e aktiviteteve të edukimit përmes kulturës në mbarë sistemin arsimor.

**Edukimi artistik:** Konsiderohet si një nga politikat më të rëndësishme duke e vënë theksin gjithmonë dhe më shumë në vëmendjen që i duhet kushtuar kësaj politike që ndikon jo vetëm në

përmirësimin e statusit të jetesës të çdo pjesëtari në komunitet, por veçanërisht edukimit cilësor nga brezi i më të vegjëlve e përgjatë gjithë edukimit arsimor, të cilët do të jenë edhe konsumatorë të produktit artistik në të ardhmen. Në vendin tonë Institucionet Qendrore të Artit zotërojnë kapacitete fizike dhe teknike që do të garantonin institucionalizimin e kësaj politike, duke sjellë dhe përfitime të dyanshme në lidhje me angazhimin e artistëve më pak të angazhuar për shkak të sistemit dhe profilit artistik në këto institucione si dhe palës tjetër përfituese të produktit artistik. Drejtoria: Propozon dhe mbështet projekte që lidhen me edukimin për art dhe kulturë për grupmoshat e ndryshme.

Mban marrëdhëniet me institucionet arsimore për të integruar edukim artistik dhe kulturor në kurrikulat shkollore;

Marrëdhënie me institucionet arsimore, kulturore, individë dhe shoqata për të krijuar hapësira multi disiplinore në këtë fushë për të rinjtë (muzikë - një instrument për çdo fëmijë); arte pamore, lexim, performanca artistike, fushata ndërgjegjësuese, etj)

Monitoron dhe kërkon lidhur me politikat që mund të ndiqen për zhvillimin e edukimit artistik dhe kulturor, sidomos për brezat e rinj.

#### **Produkt D : Përfaqësime në programe dhe evenimente ndërkombëtare**

Marrëdhënie kulturore (*cultural affairs*): Drejtoria mban marrëdhënie periodike me institucionet dhe subjektet ndërkombëtare ku prezantohet arti shqiptar dhe artisti shqiptar (si psh. Bienale e Venecias, Bienalja e Mesdheut, Rezidenca Artistësh etj), si dhe krijon kontakte të reja dhe propozon hapësira kulturore dhe artistike që mund të prezantohen në të ardhmen;

Mban marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare me të cilat Ministria e Kulturës është partnere në projekte ose ndjek propozimet për projekte bashkëpunimi midis shteteve por edhe ndjek aplikimet për fonde për projektet (si psh Regione Puglia dhe të tjerë);

Ndjek projektet dhe thirrjet për aplikim në Creative Europe dhe bashkëpunon me drejtorinë e BE-së për propozim projektsh të tjera;

Mban marrëdhëniet me ambasadat shqiptare në botë për të promovuar Shqipërinë artistike dhe kulturore dhe nxitur zhvillimin e turizmit kulturor, si dhe peshën ekonomike të kulturës pranë diplomatëve të fokusuar në zhvillimin e diplomacisë ekonomike (sic është udhëzuar dhe nga KM për 4 vitet e ardhshme të qeverisjes);

Monitoron dhe kërkon publikimet dhe dokumente të rëndësishëm të publikuar në kontekstin e zhvillimit të kulturës dhe artit në institucione të BE-së, Council of Europe, UNESCO etj.

Drejtoria jep kontribut të drejtpërdrejt për hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike kombëtare, si:

Strategjisë Kombëtare për Artin, Kulturën dhe Trashëgiminë: *në proces*

Në nivel ndër sektorial përfaqësohemi si pjesë e grupeve të punës

PAK; Pakicat dhe Minoritetet, Ndihma Shtetërore; Mbrojtja e të drejtave të Fëmijëve, etj.

DIASPORA;

Drejtoria referon për dokumente kombëtare/ndërkombëtare, të cilat janë në proces raportimi dhe përditësimi periodik:

Progres Raporti i Bashkimit Evropian

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI);

Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA);

SEE;

#### **Prioritete 2019:**

Kalendarë të pasur dhe të suksesshëm artistik në Institucionet e art-kulturës;

Vijimi i Investimeve në infrastrukturë dhe shërbime;

Mbështetja e Skenës dhe Industrive Krijuese në Art-Kulturë

Programi Kombëtar i Edukimit Kulturor;

Dokumenti “Pakti i Studentëve”

Programi Mbarëkombëtar për Diasporën;

Kalendari Turistik në shërbim të Turizmit Kulturor.

Pasaporta jonë kulturore, përfaqësime elitare ndërkombëtare

#### **Projekte në proces:**

Thirrja Publike: në proces vlerësimi;

Bienale e Artit në Venecia: 2019, në proces krijimi Pavijonit Shqiptar

Balkan Trafik, Koordinimi me përfaqësinë tonë diplomatike në Bruksel dhe organizatorët e festivalit.

Diaspora: Në proces Kalendari i Aktiviteteve që zhvillohen për Diasporën dhe në shërbim të Diasporës;

“Sorkadhet e Trembura - *Filmi Gjirokastra*”; i autorit Ismail Kadare:

*Duke ju falenderuar për vëmëndjen,*



